

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XVI i botimit, nr. 191, Shtator 2019

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355674001940, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Suela Ndoja, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

"NJË PIKË LEHTËSIMI NË NJË OQEAN VUAJTJESH"

3

Tre vite më parë, Shën Nënë Tereza u kthye në shenjte e Kishës Katolike, pasi Papa Françesku njohu mrekullinë e dytë të saj, atë të shërimit të një burri brazilian nga disa tumore.

Angje Gonxhe Bojaxhiu, që më vonë e ndryshoi emrin në Nënë Tereza u lind në Shkup, më 1910 nga prindër shqiptarë. Që në moshën 12 vjeç kishte dëshirë të bëhej misionare "për të përhapur mesazhin e dashurisë së Krishtit". Shën Nënë Tereza u largua më 26 shtator 1928 nga Shkupi në drejtim të Dublinit, Irlandë. Prej kësaj dite, nënë, bijë e motër nuk do të shiheshin më kurrë.



FESTË E MADHE NË LOGUN E BJESHKËVE

Bjeshkët e Kelmendit zgjedhin vajzën më të bukur: "Miss Bjeshka 2019"

Nga Amfiteatri i Qafës së Prodolecit na thërret kënga Maje Krahu me u mledh prap në Logun e Bjeshkëve të Kelmendit.

"Dola n'bjeshkë stanin punova
Me ujë bore u freskova
Çpo i bjen fyellit çobani
Kur syzeza del prej t'banit"

Nën ritmin e këtyre vargjeve të bukura të këngës që i paharruari Arben Delaj, "Bilbili i Këngës së Malësisë së Madhe, la një trashëgëmi të pasur me një reportor të admirueshëm, i cili u nda nga jeta në moshë fare të re, u hap edhe këtë vit kjo festë e madhe popullore në trevat e Malësisë "Logu i Bjeshkëve", edicioni i 19-të.

E nisëm udhëtimin tonë për në "Logun e Bjeshkëve" të Kelmendit, në edicionin e 19 të "Miss Bjeshkës", në një sinfoni të larmishme tingujsh, në një mozaik ngjyrash, nën peisazhin mahnitës të Kelmendit. Për të arritur në këtë edicion ...

MENDO GLOBALISHT DHE VEPRO LOKALISHT

"Mendo globalisht dhe vepra lokalisht", këtë thënie e kam dëgjuar për herë të parë nga trashëgimtarja e një prej kompanive më të hershme në Gjermani dhe mu duk më me vend se asnjëherë tjetër ta përdorja edhe për Shqipërinë dhe principimin e shoqërisë tonë drejt evropiane.

DUKAGJINI DHE NATYRA

Sikur të kisha qënë në takim me perënditë dhe të kërkoja se si ta ndërtoja Dukagjinin, nuk do isha në gjendjen ti rendisja gjitha ato që Zoti ja fali kësaj treve. Një territor i ndodhur mes Alpeve të Ballkanit, që shtrihen nga një lartësi, që fillon nga 220 metra mbi nivelin e detit (Prekal) e lartë në drejtim të perëndive në lartasin mbi 2570 metra (Jezerçës). Sipërfaqja e kësaj treve është ...

HUMANIZMI I NJË MJEKJE ZVICERANE, MIKE E SHQIPTARËVE

Duke lexuar Zhyl Vernin, që është shprehur aq bukur: "Kur nuk krijohet nuk ndiej jetë në veten time", mendova t'ju sjell sot kujtimet e mia të paharruara për një mjek humaniste zvicerane, me të cilën kam punuar vite të tëra. Prej vitesh kam ndarë me të dhe personelin human mjekues, mjekë dhe infermierë në Gjenevë, para fillimit të një konsulte, "kruasantin" (croissant) dhe kafën e mëngjesit, duke diskutuar lirshëm dhe si midis kolegësh, që na bashkon një qëllim: si të përmirësojmë bisedën me një pacient nga Shqipëria, Kosova apo nga viset, Maqedonia e Veriut, apo me bashkëkombës shqiptarë që janë vendosur në Zvicër, qoftë edhe përkohësisht. Kemi folur për atë gruan shqiptare që nuk dinte asnjë fjalë frëngjisht dhe dëshirën e saj për të kuptuar gjithçka nga biseda, për prindin e asaj fëmije që nuk ka konsultuar asnjëherë mjek në fshatin e saj, diku në Kosovë, për të mjetesh dhe personeli mjekësor. ...

U RRËZUA SHQIPTARI MË I FUQISHËM I BREZIT TË TIJ Mirash Vuksani (Shala)

Me datë 5 shtator 2019, n u rrëzua me "tuç" njeriu më i fuqishëm i tapetit, që mbretëroi me pallën e despotit për një dekadë në fronin e mundjes shqiptare. Klasiku i mundjes klasike, ahu i vjetër dhe madhështor u shemb e ra hordovel, duke lenë pa mriiz logun epik të kampionëve të lavdishëm të tapetit shkodranë. Njeriu historik, që nuk u tund nga as një vampir në vitet 60-70-të, të shekullit të tij më në fund u dorëzua përpara një "amazone" që e dashuroj me xhelozin për një jetë të terë. Mortja shamizezë erdhi natën për terr dhe e shytoj brinjë më brinjë për të mos u ngritur kurrë më dragoin triumfues të qindra mejdaneve që nuk e dinte se çfarë është tuta! ...

MENDO GLOBALISHT DHE VEPRO LOKALISHT

“Mendo globalisht dhe vepra lokale”, këtë thënie e kam dëgjuar për herë të parë nga trashëgimtarja e një prej kompanive më të hershme në Gjermani dhe mu duk më me vend se asnjëherë tjetër ta përdorja edhe për Shqipërinë dhe emancipimin e shoqërisë tonë drejt vlerave evropiane.

Për të diskutuar për këtë temë e mora frymëzim nga një bisedë me një çift spanjoll në avion, sepse për pushimet e tyre verore kishin zgjedh Shqipërinë, dhe në momentin që u kishin thënë miqve që kanë zgjedh Shqipërinë janë “tmeruar” duke parë imazhin e Shqipërisë të shpërndarë nëpër rrjetet sociale dhe internet dhe më shumë së askush në këtë hap jemi ne, vetë që e kemi shpërndarë këtë imazh veçanërisht këtë imazh jo pozitiv e kanë alpet e veriut, që duken si të frikshme ose njerëzit si të ashpër. Po janë male të reja sigurisht edhe majat janë të thepisura, por janë shumë mikpritëse, mund të ndalosh kudo të shuash etjen, mundesh të çlodhesh sytë në horizontin e pafund të bukurisë, por diku aty –këtu ka edhe fruta të egra që të kaloni udhëtimin, me e bë më të lehtë, ose për njerëzit që thonë se janë të ashpër, është e vërtetë se nëna që gatuan bukën e “mbrume” i ka duart e ashpra, po jo zemrën, ka rrudhat në ballë me hijeshi që tregon se nuk e ka pas të lehtë si të gjithë femrat Shqiptare, por flet butë, e burrat pastaj që kanë të gjithë atë karakter të forte e të pamposhtur e nëse shkon mik të presin me zemër të bardhe e tërvesen më çfarë të kenë, por...është ky imazhi që na vendos gjithmonë para përgjegjësisë, ...

Vetëm para disa ditëve dy turistë vajza, njëra polake dhe tjetra gjermane “humbën” dhe i gjithë opinioni publik, media, rrjetet sociale dukë kërkuar ndihmë ti gjenin e duke “dënuar” Alpet, e kur u gjetën thanë nuk kemi humbur thjesht, nuk kemi pas valë telefoni edhe kemi qenë në shëtitje..., por është ky imazhi... e megjithatë fatmirësisht ka njerëz dhe turistë të guximshëm që shkojnë në Alpe, në malet tona dhe e përcjellin fjalën e



mirë.

Nga një studim që kam bërë për çështje akademike diplome nga përgjigjet e pothuajse 100 turistëve për sa i përket pyetjes, se pse kanë zgjedhur vendin tonë kryesisht nga Shkodra dhe në drejtim të Veriut, ishte nga një mik ose i njohur që kanë qenë para tyre dhe asnjë prej ndonjë agjencie ose ajo që është më e rëndësishme nga miqtë e tyre Shqiptare ose nga rrjetet sociale, dhe pikërisht këtu qëndron thelbi...

Ne, po jetojmë në kohën më të mirë të përcjelljes së shpejtë të informacionit nëpërmjet medias sociale, sidomos të rinjtë kanë forcën të ndryshojnë rrjedhën e ngjarjeve, imazhin, jemi në kohën e “influencave”, jemi në kohën e ndikuesve të rrjeteve sociale, që mund të promovojmë vlerat dhe jo vlerat tona.

Të gjitha shtetet kanë vlera dhe jo vlera, por të gjithë promovojnë anët pozitive duke thënë pse duhet ta vizitojmë Italinë, Zvicrën, Gjermaninë e të tjera dhe jo pse nuk duhet të vizitojmë këtë apo atë vend siç bëjmë disa nga ne...

Në fjalimin e famshëm në marrjen e presidencës John Kenedy, në mes të tjerave theksoi ...”Jeni mësuar t’ju themi

ne, se çfarë mund të bëjmë ne, për vendin tuaj, por është momenti të dini ju çfarë të bëni për vendin tuaj, duke i vendosur para përgjegjësisë dhe mbi të gjitha para procesit të vendimmarrjes, duke e bërë secilin të ndjehet shtetas i Amerikës... unë e di që sistemi ynë për momentin nuk është i duhuri, por ne kemi në dorë shumë, në kohën e internetit të gjithëve na dëgjohet zëri, nëpërmjet një statusi, nëpërmjet një logu”. Nëpërmjet një fotoje, nëse e fillojmë secili me pak mund të bëhet shumë, prandaj mesazhi më i mirë mund të jepet, është lëreni shpirtin tuaj të lulëzojë për vendin tonë, bëhuni vetë vendimmarrësit e vendit, të qyteti e të lagjes tuaj, të vendit të origjinës tuaj, se ne e dimë dikush më shumë e dikush më pak të gjitha nga fshati jemi, se është ky fenomeni që nga të rinjtë stепен kur tregohet origjinal!

Të dashur të rinj ndiqni dritën, ëndrrat e punën, por mos harroni kurrë rrënjët... prandaj edhe Shoqata Atdhetare “Dukagjini”, për t’ju afruar të rinjve ka marrë një mision të ri “Puna dhe përpjekjet që duhen bërë, krahas vijimit të njohjes së mëtejshme e promovimit të vlerave të zonës së Dukagjinit, për emancipimin

shoqëror të dukagjinave kudo janë, me objektivin që si qytetar të mirë e në bashkëpunim me njeri - tjetrin, të ecim përpara drejt standardeve evropiane”, edhe ftoj të gjithë të rinjtë të bëhen pjese aktive e arrijës së këtij misioni, sepse veprimtaritë e zhvilluara janë të shumta, por kur jemi më shumë përcjellin me shumë, themi më shumë edhe idetë e ndara janë të mëdha dhe mund të kthejmë faqen duke ndryshuar veten tonë, të besojmë tek vlerat që Dukagjini, Alpet dhe njerëzit, secili prej nesh ka, se historia e ka treguar se qëndresat e bëra në këto male dhe vlerat artistike janë të patjetërsuar dhe burim frymëzimi për çdo të ri, që beson se mund të bëjmë më shumë, setë qëndrojmë 70 % të kohës tonë, që nuk kthehet, ne kafe ose duke bërë gjëra të padobishme, të cilat nuk na shërbejnë për të mirën e përbashkët, të quajtur Shqipëri, por edhe të mirën individuale të quajtur e ardhme...

Blog*- Nga anglishtja një tekst i shkurtër, mendime të një personi ose një grupi të vogël mbi eksperiencat personale

Nga Klodjana Serraj

TOKA - MALET DHE PYJET..!

Pergatiti: Ing. Mehmet Metaj
Drejtor i Qendres “Albaforest”

Toka-Planeti: është krijuar 600 milion vjet më parë; "Bota - planeti është ne rrezik jo nga ata që e dëmtojnë por nga ta që e shohin këtë që po ndodh dhe mbajnë sehir". - (Albert Einstein);

Malet mbulojnë rreth 27 përqind të sipërfaqes së tokës së tokës, dhe pyjet mbulojnë më shumë se 40 përqind të zonës globale malore. Pyjet e shëndetshme malore janë thelbësore për shëndetin ekologjik të botës. Ata mbrojnë ujëmbledhës që furnizojnë ujë të ëmbël për më shumë se gjysmën e njerëzimit. Ato gjithashtu strehojnë jetën e egër, sigurojnë ushqim dhe foragjere për popujt malorë dhe janë burime të rëndësishme të

lëndëve drusore dhe produkteve jo druri. Për më tepër, ata mbrojnë tokën dhe kontribojnë në mbrojtjen e atmosferës nga emetimet e CO2.

Pyjet janë krijuar-instaluar-formuar: 100 milion vjet më parë;

-Pyjet ne Botë: Në gjithë rruzullin tokësor janë 4,1 miliard ha pyje. Nga sipërfaqja e përgjithshme e planetit tonë (Tokës) prej 51 miliard ha, 74 % mbulohet nga uji (oqeanet, detet, liqenet, lumenjt) kuse 26 % është tokë e that që përbën 13,18 miliard ha. Dhe 31 % e kësaj tëke të thatë mbulohet nga pyjet, d.m.th afro 8 % e sipërfaqes së tokës së planetit. Po të zbriten këtu pyjet e ulëta (shkurre) të rritura në kufijt e kënetave dhe të tundrës, në shkretëtira dhe gjysëmshkretëtira, mbeten vetëm 5 % pyje të lartë. Per rreth 6,3 miliard popullsi i bie 0,6 ha pyll per banor. Ky është një thesar madhështor i tokës për njerëzimin.

• Pyjet mbulojnë 31% të sipërfaqes totale të tokës.

- Jeta e 1.6 miliard njerëz varet nga pyjet.
- Pyjet ofrojnë vendbanim për të më shumë se 300 milionë njerëz në mbarë botën.
- Pyjet janë shtëpia-vendbanimi i 80% të biodiversitetit tokësor.
- Pyjet ne Evropë: Pyjet mbulojnë më shumë se një të tretën e sipërfaqes së tokës të Evropës (45 % ose 1.02 miliard hektarë) dhe zona pyjore e saj vazhdon të rritet. Pyjet e menaxhuara në mënyrë të qëndrueshme ndihmojnë për të ngadalësuar efektet e ndryshimeve klimatike dhe për të zvogëluar emetimet e gazrave serrë në atmosferë. Sekuestruesit e biomasës pyjore evropiane kanë një mesatare prej 719 milion ton CO2 çdo vit, që korrespondon me rreth 9% të emetimeve neto të gazeve serrë të Evropës. Krahasuar me disa rajone të shpyllëzimit, zona pyjore e Evropës dhe burimet e drurit vazhdojnë të rriten. Pyjet mbu-

lojnë rreth 45 përqind të tokës evropiane. Europa ka rreth 25 përqind të pyjeve të botës, nga të cilat 80 përqind janë në Federatën Ruse. Përveç kësaj, produktet pyjore ofrojnë një burim natyror dhe të rinovueshëm të karbonit neutral. Politika e pyjeve në Evropë ka një fokus të fortë në biodiversitetin. Gjatë 15 viteve të fundit, zona e Evropës e pyjeve të mbrojtura është rritur çdo vit me gjysmë milioni hektarë.

Zhveshja nga pyjet përmbyt Shqipërinë vit pas viti. “Pyjet e vërtetë do të mbanin rreth 20 % të reshjeve” Kemi mbushje të baseneve ujëmbledhës të hidrocentraleve në masën mbi 30% për rreth 40 vjet dhe ato po shkojnë drejt skadencës (nga 100 vjet të parashikuara në projekt), që një ditë do të bëhen shqetësim për ne, por për më gjerë.

“NJË PIKË LEHTËSIMI NË NJË OQEAN VUAJTJESH”

Përgatiti Roza Pjetri

Tre vite më parë, Shën Nënë Tereza u kthye në shenjte e Kishës Katolike, pasi Papa Françesku njohu mrekullinë e dytë të saj, atë të shërimit të një burri brazilian nga disa tumore.

Angje Gonxhe Bojaxhiu, që më vonë e ndryshoi emrin në Nënë Tereza u lind në Shkup, më 1910 nga prindër shqiptarë. Që në moshën 12 vjeç kishte dëshirë të bëhej misionare “për të përhapur mesazhin e dashurisë së Krishtit”. Shën Nënë Tereza u largua më 26 shtator 1928 nga Shkupi në drejtim të Dublinit, Irlandë. Prej kësaj dite, nënë, bijë e motër nuk do të shiheshin më kurrë.

Në moshën 18 vjeç hyri në urdhrin e motrave të Notre-Dame de Lorette, në Dublin, që punonte me arkipeshkvinë e Kalkutës.

Shën Nënë Tereza nuk mund të braktiste urdhrin e saj pa pëlqimin e arkipeshkvit të Kalkutës, Ati Ferdinand Periers, i cili nuk e vlerësonte sa duhet. “Është një fillestare që nuk do të ishte në gjendje të ndizte si duhet një qiri”, mësohet të ketë thënë prelati.

Nëna e saj superiore në Dublin dhe Papa kishin më shumë besim tek ajo. Dhe në fillim të vitit 1948, ajo lejohet të largohet nga urdhri. Bëhet atëherë Nënë Tereza për nder të shenjtore franceze Sainte-Terese e Lisieux dhe vendoset në barakat e Kalkutës, në Indi, ku në vitin 1950 themeloi urdhrin e saj të murgeshave të quajtur Misionaret e Bamirësisë. Nga ajo kohë iu dedikua tërësisht të varfërve.

Në vitin 1952, ajo takoj një grua të braktisur që po jepte shpirt mbi një trotuar në rrugët e Kalkutës, me këmbët të brejtura nga minjtë, e bënë atë të ndërmerre një nga detyrat për të cilat ajo u admirua më shumë, kujdesin për njerëzit duke dhënë shpirt.

Siç ka kujtuar Shën Nënë Tereza “e morëm këtë grua në shtëpinë tonë, ku e ndihmuam shumë. Pas pak orësh ajo u nda nga kjo botë, por vdiq ne paqe. Sa ishte gjallë nuk pushoi së uruari për ndihmën që i kishim dhënë. Unë mund ta ndihmoj një njeri që të vdes në paqe dhe me dinjitet”.

Pas këtij rasti kritikoi ashpër autoritetet e Kalkutës dhe arriti të siguronte një ndërtesë të shekullit të XIX, pranë tempullit Kali, Perëndesha hindu e vdekjes. Atje do të priste të gjithë ata që vuanin nga tuberkulozi, nga dizenteria, ose tetanos, të cilët nuk i pranonin spitalet. Për 40 vjet, më se 30 000 persona vdiqën atje. Për Nënë Terezën, garantimi i “një fundi të denjë” për ata që kanë “jetuar si kafshë” është një detyrë.

Krahas kësaj, misioni i saj punonte në ndihmë të strehimit të fëmijëve të braktisur në gjithë botën, kurimit të leprozëve, në ndihmë viktimave të Sidës, dhe kishte

hapur një qendër për ta në Shtetet e Bashkuara.

E veshur gjithnjë me mantelin e bardhë me shirita blu të urdhrin të Misionareve të Bamirësisë, Shën Nënë Tereza e kishte zakon të thoshte se vepra e jetës së saj nuk ishte veçse “një pikë lehtësimi në një oqean vujtjesh”. Por, shtonte ajo, “nëse kjo pikë nuk ekzistonte, ajo do t’i mungonte detit”.

Në shtëpinë e Loëe Circular Road, një rrugë e vogël në qendër të Kalkutës, ajo bënte jetën e thjeshtë të postulateve të kongregacionit të saj, merrte pjesë në punët shtëpiake të komunitetit. Dhoma e saj e vogël ishte e mbushur me dosje dhe

fonde në ndihmë të të varfërve.

Disa e qortuan se kishte siguruar fonde nga persona pak të pëlqyeshëm, si ish-diktatori haitian Jean-Claude Duvalier. Shën Nënë Tereza nuk e pranoi asnjëherë famën. Ajo ka thënë se gjithçka e bënte për hir të dashurisë së Zotit. Bëri një jetë të thjeshtë, pa pasuri. Por fama e Nënë Terezë u përhap në vitin 1970, kur gazetari i njohur britanik, Nugerigj shkroi një libër dhe xhironi një film për jetën e saj të titulluar “Diçka e bukur për zotin”. Ish-ateist ai tha se ajo kishte influencuar jashtëzakonisht shumë në konvertimin e tij në katolik.

Në vitin 1979, Çmimi Nobel i Paqes,

cilin e formoi në vitin 1950.

Shtëpinë e Nënë Terezës e kanë vizituar personalitete si mbretëresha e Britanisë, ish presidentët e Shteteve të Bashkuara George Bush e Jimmy Carter, Yasser Arafati, princesha Diana e shumë të tjerë. Shën Nënë Tereza ka qenë mjaft bujare, humane e zemërgjerë dhe këto janë karakteristikat që do ta bëjnë të jetojë përgjithmonë në zemrat e gjithë njerëzve, sidomos në zemrat e shqiptarëve.

Kanë thënë për Shën Nënë Terezën

Papa Gjon Pali II: “Një grua që i dha formë historisë së këtij shekulli. Një shembull i shkëlqyer i asaj, se si dashuria



libra fetarë, të vetmit që ajo pranonte të lexonte.

E lidhur me vlerat më tradicionale të Kishës, besimtarja kishte siguruar një ditë se nëse do të kishte jetuar në periudhën e Galileut, ajo do t’i kishte dhënë të drejtë Kishës kundër tij. Ajo kundërshtonte gjithnjë të gjitha format e abortit.

Grua e vendosur, e guximshme, pragmatike dhe e pajisur me njohuri të mira për bizneset, një ditë kur po kalonte në Romë, i kërkoi Gjon Palit II një pjesë të pasurive të Vatikanit për të varfrit e saj. Papa i dhuroi makinën e tij Rolls Royce, që ajo e shiti në ankand me një çmim shumë të leverdishëm për të siguruar

shpërbleu punën e palodhshme të Nënë Terezës në favor të të varfërve dhe personave që ishin duke dhënë shpirt, duke i dhënë një autoritet botëror asaj që shumë prej adhuruesve e konsiderojnë si një shenjtore.

“Shenjtore e të varfërve”, Shën Nënë Tereza ndërroi jetë në 5 shtator 1997, në moshën 87 vjeç, pas një gjysmë shekulli shërbim ndaj të braktisurve në Indi dhe në mbarë botën. Në vitin 1997, pak para se të ndahej nga jeta, Shën Nënë Tereza kishte 4000 motra, të pranishme në 610 shtëpi misionare, të përhapura në 123 vende të botës. Ajo prehet në selinë e Urdhrin të Misionarëve të Bamirësisë në Kalkuta, të

për Zotin shndërrohet në dashuri për atë që ke pranë. Ajo zgjodhi të ishte jo vetëm e fundmja, por edhe shërbëtorja e të fundmëve, duke e quajtur veten gjithashtu një ikonë të gjallë të dhembshurisë”.

Ish-kryeministria e Indise, **Indira Gandhi:** “Të takosh Nënë Terezën do të thotë të përjetosh ndjenjën e inferioritetit dhe atë të pushtetit të madh të mirësisë dhe të fuqisë së dashurisë”.

Shkrimtari francez **Dominique Lapierre:** “Për mua ajo ka qenë dhe është një shenjtore në zemrat e të varfërve në botë. Mua nuk më nevojitet nënshkrimi i ndonjë kleriku në ndonjë dokument për të vendosur që ajo është

shenjtores”.

Gazeta “Oregon” e Portlandit: “Përkushtimi i Nënë Terezës ndaj të varfërve ka qenë një frymëzim që ka kapërcyer kufijtë e shteteve dhe të feve, duke pasqyruar gjithçka më të mirë: njerëzimin. Trashëgimia e saj është Urdhri që ajo themeloi, i cili përfshin 4 mijë murgesha dhe ndihmës së tyre laike. Puna e saj na kujton detyrimin tonë për të bërë atë që na takon”.

Gazeta “Boston Globe”: “Shën Nënë Tereza nuk vdiq e re, ajo jetoj një jetë të plotë dhe të frytshme, duke u ofruar ndihmë jetimëve të braktisur, të sëmurëve dhe atyre me një këmbë në varr, të cilët i adoptoi si të ishin fëmijët e saj. Ajo është shpërblyer me disa nga nderimet më të mëdha që mund të ofroje njerëzimi, përfshirë çmimin Nobel për Paqen. Ajo nuk frymëzoi njerëzit përmes reklameve dhe çmimeve, por përmes përkushtimit, shembullit personal dhe punës”.

Gazeta “The harpert Curent”: “Mbretërit, mbretëreshat, presidentët, kryeministrat, patriarkët dhe papët vijnë dhe ikin, po ashtu edhe fituesit e çmimit Nobel, por Nënë Terezë do të ketë vetëm një: ajo jetoj në brezin tonë, në shekullin tonë dhe ne i jemi mirënjohës për këtë”.

Në çastin e marrjes së Çmimit Nobel në vitin 1979, Shën Nënë Tereza deklaroi: “Kam lindur në Shkup, jam shkolluar në Londër, jetoj në Kalkutë dhe punoj për të gjithë njerëzit e varfër në Botë. Atdheu im është një vend i vogël me emrin Shqipëri”.

Thënje dhe Poezi nga Shën Nënë Tereza

1. “E dijmë shumë mirë se punët që bëjmë nuk janë më shumë se një pikë uji në oqean. Por në qoftë se ajo pikë uji nuk është atje, oqeanit i mungon diçka.

2. Nuk është e rëndësishme çka bëjmë, por është e rëndësishme sa dashuri i kushtojmë punës që bëjmë: gjërat e vogla duhet t’i bëjmë me shumë dashuri.

3. Unë nuk e zbulova Krishtin, Ai më zbuloi mua.

4. Çdo gjë është e vogël. Por kur e japim në emër të Zotit, bëhet jashtzakonisht e madhe.

5. Kurrë nuk do ta kuptojmë sa të mira mund të sjellë një buzëqeshje. Buzëqeshja është si një lidhje fizike që sjellë diçka të veçantë nga Perëndia për jetën e njeriut.

6. Kur qeshë, Unë dëgjoj muzikën e buzëqeshjes tënde.

7. Gëzimi rrezaton nga syri juaj, nga fytyra juaj, në çdo moment. Mos e vra gëzimin, sepse do të shpërthejë. Kur të tjerët shohin gëzim në sytë tuaj, ata shohin se jeni fëmijët e Zotit.

8. Gjithmonë duhet të kemi gëzim në buzët tona, për çdo fëmijë dhe person që mund të ndihmojmë. Do të ishte gabim fatal në qoftë se jemi të shqetësuar vetëm për ilaçet e tyre. Duhet t’u japim zemrën dhe dashurinë tonë.

Në shtëpinë tonë jetonte një fëmijë shumë i thatë, që nuk hante asgjë. Ishte i dëshpëruar sepse ato ditë i kishte vdekur nëna. Kërkova një murgeshë që i përgjante nënës së tij dhe e porosita murgeshën që të mos bënte tjetër vetëm të luante me vogëlushin. Pas pak kohe ky fëmijë u qetësua dhe filloi jetën normale.

10. Varfëria nuk është krijuar nga Zoti. Ne e kemi prodhuar vet varfërinë—ju dhe Unë—me egoizmin tonë.

11. Është më vështirë të luftojmë varfërinë në vendet e pasura se në ato të varfërat.

12. Sikur të kishte të varfër në hënë, duhej të shkonim atje.

13. Mund ta gjeni Kalkutën kudo në botë. Vetëm duhen sytë për ta parë. Kudo në botë jetojnë njerëz që nuk i do kush, njerëz që nuk u ndihmon kush, që janë të braktisur dhe të harruar dhe kjo është varfëria më e madhe.



14. Për çdo sëmundje ekzistojnë ilaçet dhe terapitë, por jo për ata që nuk i do kush. Kjo është gërbula e Perëndimit.

15. Unë besoj se të pasurit janë më të varfër se të varfërit, sepse ata shumë herë nuk janë të lumtur. Sa ma shumë që kanë, kërkojnë edhe më tepër. Por nuk janë të gjithë të tillë....

16. Jam e bindur se tortura më e madhe kundër njeriut është ndjenja e braktisjes.

17. Fëmijët janë dhurata më e bukur e Zotit. Çdo fëmijë ka të drejtë të vijë në këtë botë pavarësisht dëshirës sonë.

18. Dashuria është fryti më i ëmbël i të gjitha stinëve dhe duhet ta shijojnë të gjithë.

19. Zoja Bekuar është dhurata më e bukur hyjnore për racën njerëzore.

20. Fjalimi publik para shumë njerëzish është torturë për mua.

21. Është më lehtë për mua të lajë një të gërbulur se t’u përgjigjem pyetjeve të gazetarëve.

22. Një gazetar Amerikan më tha një herë: “Nënë Tereza: “çfare bën ti nuk do ta bëja për një milion dollarë”. Nënë Tereza iu përgjigj: “As Unë nuk do ta bëja këtë punë për miliona dollarë”.

23. Një gazetar e pyeti njëherë Nënë Terezë, “Çka duhet të ndryshohet në kishë?” Ajo u përgjigj: “Unë dhe Ti”.

24. Ata që janë të lumtur predikojnë edhe kur nuk predikojnë.

25. Pemët, lulet dhe bari rriten në qetësi. Yjet, dielli dhe hëna levizin në qetësi. Qetësia u jep vizion gjërave.

26. Lutjet na e bëjnë zemrën e pastër dhe zemra e pastër është në gjendje të shikojë Zotin.

27. Mendo: se Krijuesi i Gjithësisë ka krijuar kohë për ne, për krijesat e tij të vogëla.

28. Jeta është e pazëvendësueshme. Duhet ta mbrojmë.

29. Fryt i qetësisë është lutja. Fryt i lutjes është besimi. Fryt i besimit është dashuria. Fryt i dashurisë është shërbimi. Fryt i shërbimit është paqa.

30. Kur lutemi, jemi rreze e shkëlqimit të dashurisë së Zotit: në shtëpi në punë dhe për gjithë botën.

31. Burimi prej ku pini ujë duhet të jetë shumë i thellë. Kështu do ta gjejnë burimin ata që i dashuron.

32. Vetëm në Parajsë do ta kuptojmë se u kemi borxh të varfërve, sepse ata na kanë ndihmuar që ta duam Zotin më shumë.

33. Shumë njerëz vdesin ashtu si kanë jetuar. Vdekja nuk është kurrëgjë më shumë se vazhdim i jetës, është plotësim i saj. Kjo jetë nuk është fundi; ata që besojnë se është fundi ata kanë frikë vdekjes. Njerëzit që binden se vdekja është kthim në shtëpinë e Zotit, ata nuk do të kenë frikë.

URATË PËR MUSLIMANË DHE HINDUISTË

O zot,
të falënderoj për muslimanë dhe hindusë.
Dhe për të gjithë miqtë e mijë të dashur në mesin e tyre.

Çdo herë kur të takojmë Ty
në uratë,
ti na bën të krishterë më të mirë,
myslimanë më të mirë,
hindusë më të mirë.
Jepna të gjithë neve
dhuratën e fesë dhe dashurisë
për të zbuluar ty.
Amen.

DËRGOMË TË DUA NDOKEND O ZOT!

Kur kam uri,
Më jep ndokënd që ka nevojë për ushqim;
kur kam etje
më jep ndokënd që ka nevojë të pijë diçka;
kur kam të ftohtë,
më jep ndokënd për ta ngrohur;
kur kam ndonjë hidhërim,
afroma ndokënd për ta këshilluar;
kur kryqi im t’ më bëhet i rëndë,
bëj t’ia marrë edhe dikujt tjetër kryqin e tij;
kur jam e varfër,
më jep ndokënd t’i jap;
kur s’kam kohë,
më jep ndokënd t’i ndihmoj për disa çaste;
Kur jam e përvuajtur,
bëj që të kem ndokënd për ta lëvduar;
kur jam e pavullnetshme,
dërgomë për ta shpirtëzuar ndokënd,
kur kam nevojë që unë të flas me ndokënd,
dërgoje dikën tjetër që të flas me mua;
kur të mendoj vetëm në vetvete,
tërhiqe vëmendjen time te ndokush tjetër.
Dendësona, Zotëri, për t’u shërbyer vëllezërve tanë
kudo që në botë ngarendin dhe jetojnë,
si varfanjakë dhe të uritur.
Jepu atyre nëpër duart tona, bukën e përditshme,
jepu atyre nëpër dashurinë tonë përshtuese
paqen dhe gëzimin.

FESTË E MADHE NË LOGUN E BJESHKËVE

Bjeshkët e Kelmendit zgjedhin vajzën më të bukur: “Miss Bjeshka 2019”

Nga **Ramazan Çeka**

Nga Amfiteatri i Qafës së Prodolecit na thërret kënga Maje Krahu me u mledh prap në Logun e Bjeshkëve të Kelmendit.

“Dola n’bjeshkë stanin punova
Me ujë bore u freskova
Çpo i bjen fyellit çobani
Kur syzeza del prej t’banit”

Nën ritmin e këtyre vargjeve të bukura të këngës që i paharruari Arben Delaj, “Bilbili i Këngës së Malësisë së Madhe, la një trashëgëmi të pasur me një reportor të admirueshëm, i cili u nda nga jeta në moshë fare të re, u hap edhe këtë vit kjo festë e madhe popullore në trevat e Malësisë “Logu i Bjeshkëve”, edicioni i 19-të.

E nisëm udhëtimin tonë për në “Logun e Bjeshkëve” të Kelmendit, në edicionin e 19 të “Miss Bjeshkës”, në një sinfoni të larmishme tingujsh, në një mozaik ngjyrash, nën peisazhin mahnitës të Kelmendit. Për të arritur në këtë edicion u desh punë, djersë, pasion, dashuri e krijimtari. Përpara mijëra shikuesëve ky spektakël solli traditë, art dhe argëtim. Këtë aktivitet e zbukuruan vajzat pjesëmarrëse në “Miss Bjeshka”, këngëtarë, valltarë dhe aktorë.

Kisha dëgjuar shumë herë e parë shumë fragmente filmike që demonstironin këndshëm këtë aktivitet unik në llojin e vet, por kurrë më parë nuk kisha marrë pjesë, ndaj për mua ishte emocion i veçantë, pasi për të parën herë arrita t’i shoh nga afër ata djem vigana me çakçir e xhamadana, e mbi të gjitha ato shtojzavalle si lule këmbane që çelin përgjatë bjeshkëve në Alpet e Shqipërisë e konkretisht në Malësi të Madhe, të ruajtura me fanatizëm “me arë e me farë” si të bekuara që në lashtësi nga vetë besimi i tyre pagan tek kulti i Diellit, atje ku “Nuset e duvakut nuserojnë nën petkun e hijshëm të xhubletës”.

Rrugën s’e ndjemë fare, pasi me standartet që ka sot, e bën shumë komod udhëtimin. Për çudinë time me të mbërritur në Qafën e Bordolecit, emër të cilin unë e kisha me kuriozitet ta di domethënien, pasi shqiptohet në disa versione po e pranoj dhe e përshkruaj kështu me që brenda këtij tokfjalëshi ka emrin e borës, si një faktor natyror që në këtë vend mbretëron dhe ka pushtet për rreth gjashtë muaj me radhë.

Gjetëm një trafik të jashtëzakonshëm, fluks makinash të paparë, të cilin me shumë vështirësi e menaxhoi edhe vetë policia, dhe pse ajo po jepte maksimumin e vet. Aq shumë pjesëmarrës kishte që vinin nga e gjithë Shqipëria dhe vendet fqinje, Dardani e Malësi, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, etj. rrugëtim tashmë i shkurtuar nga Dogana e Vermoshtit, fare pranë Qafës së Prodolecit.

Një organizim i paparë i improvizuar në natyrë si në një amfiteatër të vërtetë, një shesh që harkohej nga një ngjitje kodrinore, një spektakël i shkëlqyer me një pejsazh mahnitës, me një pjesëmarrje

masive që e bënte atë shumë transparent për të kapur çdo detaj të interpretimeve skenike të artistëve nga spektatorët e pranishëm.

Ky spektakël i mrekullueshëm startoi me tre të shtëna arme që simbolizojnë gëzim. U dëgjua zëri i fuqishëm i aktorit Bruno Shllaku: “Oooooooooo ça është pushka more ehehejjjjjjj”, duke u pasuar nga aktori tjetër Çun Lajçi: “Ohooooo shtegut të malit po ulen bukuroshet e Bjeshkëve” dhe menjëherë vajzat bukuroshe filluan ngjitjen në skenë ku i prit lodërtari me flamur.

Më ra në sy pjesëmarrja e shumë artistëve, të cilët vinin për herë të parë në Logun e interpretonin me një emocion tepër të fortë. Një interpretim virtuoz bëri aktori Çun Lajçaj, një artist i madh që me interpretimin e tij të shkëlqyer e ngriti spektatorin në këmbë dhe e bëri që ta duartrokasë me krenari e respekt të veçantë.

Malësori Nikollë Nikprelaj, “Mjeshtëri i Merituar”, solli një atmosferë të zjarrtë, duke bërë që gjithë rinia artëdashëse, por jo vetëm, të zbriste në sheshin e logut dhe të vallzonte për minuta të tëra, dukej sikur edhe libreti i aktivitetit u shpërfill nga vala



e kënaqësisë dhe gëzimit që i përfshiu me emocionin e atyre tingujve të këngëve që vetë ky këngëtarë me orkestrën e tij të mrekullueshme u munduan të përzgjedhin nga repertori i tyre. Këto këngë hite nuk kishin se si të mos ngrinin në këmbë publikun e pranishëm. E gjithë lugina dhe shpatet e saj morën pamjen e një skene të madhe.

Në skenë u ngjitën lahutarë e këngëtarë kelmendas, si Jonuz Delaj e Luigj Tinaj, Nikollë Buçi, Fredi Delaj, Klodiana Vata, Kjara Pepushaj, Gabriel Rraposhi, Ylli Sufaj, Arton Nikprelaj, Llesh dhe Gjin Prenga, si dhe këngëtarë të tjerë të ardhur nga diaspora, të cilët me interpretimin e tyre tepër të bukur e tradicional, përcollën mesazhin e dashurisë për vendlindjen e tyre.

Ky spektakël madhështor kishte nevojë edhe për humorin e hollë që karakterizon Malësinë dhe këto momente kaq të bukura i përjetuam kur në skenë u ngjitën humoristët Drande Xhai, Marash Kaçaj dhe Gëzim Mezini, të cilët me performancën e tyre të shkëlqyer i dhanë larmi e atmosferë këtij spektakli kaq masiv.

Ajo që fare mirë mund të quhet arritje e kësaj veprimtarie, u menaxhua në mënyrë

perfekte nga aktori dhe regjisori i mirënjohur i Teatrit “Migjeni” Bruno Shllaku dhe moderatorja simpatike Valbona Preldakaj e ardhur nga Amerika e Largët.

Libreti i përgatitur me aq larmi dhe profesionalizëm nga Donika Velaj, pasqyrore të gjitha vlerat e trashëguara nga tradita, si dhe ato bashkëkohore, historike e kulturore, që të gjithë brezat e malësorëve i trashëgojnë njëri-tjetrit.

Sa bukur tingëllonin prezantimet dhe interpretimet që bënte aktori virtuoz Bruno Shllaku mes Bjeshkëve të Kelmendit, duke përcjellur zërin e fuqishëm që vjen nga Eposi i Kreshnikëve.

Ajo që i dha kuptimin e vërtetë Logut të Bjeshkëve dhe që bëri lidhjen me traditën e Malësisë së Madhe ishin dhjetë vajzat pjesëmarrëse në konkurim, të bukura e fisnike, të cilat me veshjet e tyre e bënë tepër të hijshme atë skenë e atë spektakël tradicional e masiv në Malësi.

Rëndësia apo dhe vlerësimi për këtë organizim shtohet nga pjesëmarrja e personazheve të rëndësishëm të pushtetit vendor, me përkushtimin maksimal të Kryetarit të Bashkisë së Malësisë së Madhe z.Tonin Marinaj, i cili me

rike, shpirtërore e kulturore që mbartë me vetvete dhe për shndërrimin e madh nga Logu historik në një Log Kulturor-artistik. Nga një kryevlerë historike në një kryevepër manifestime madhështore, ku demonstrohen këngët kreshnike, ku konkurojnë këngëtarët, valltarët, instrumentistët më të talentuar, kostumet kombëtare, konkurojnë prodhimet e vendit dhe garimet tradicionale, duke e kthyer në kryefestën e gjallërimit të të gjithë jetës në Kelmend dhe në një destinacion të rëndësishëm turistik. Në këto manifestime madhështore janë shkrirë akujt e urrejtjes dhe konflikteve. Këtu zënë fill fejesat e dashurisë. Këtu janë shtuar dhe forcar miqësitë. Këtu mes bukurive mahnitëse të këtyre Alpeve dhe të luleve konkurojnë çdo vit dhe kryevlera e Logut që është Miss Bukuria, ku garon kryebukuria njerëzore me vajzat e Malësisë së Madhe si më të bukurat e Botës”.

Aktiviteti kulmoi me sofrën e shtruar tek Bujtina Alpin në Lëpushë, e cila veç traditës së mikpritjes na ofroi edhe bujarinë tradicionale të kullës malësore në Alpet Shqiptare. Rreth sofrës u mblodhen shumë figura të shquara të artit, politikës, pushtetit vendor e qëndror si, dhe aktivist të ndryshëm të jetës sociale. Ndër ta edhe artisti i shquar Çun Lajçaj me bashkëshorten e tij, drejtori i përgjithshëm i Qendrës së Artit dhe Kulturës Shqiptare z.Minella Kureta, deputeti i zonës Pavlin Sterkaj, kryebashkiaku Tonin Marinaj e plot të tjerë.

Bisedat rrodhën këndshëm rreth aktivitetit, fakteve historike e kulturore të Malësisë së Madhe e deri tek risitë kulturore apo dhe ngërçet që e çënojnë mbarëvajtjen e saj, të vëna në dukje kryesisht nga zonj. Rita Shkurtaç, profesoresha e nderuar e historisë, pjesë e stafit tonë, e cila me kërkesë të drejtorit të përgjithshëm të Qendrës së Artit dhe Kulturës Shqiptare z.Minella Kureta, na shoqëroi edhe tek sofrat. Shqetësimi i saj lidhej me një pjesëmarrje më të gjërë të artistëve vendas e ndoshta edhe me një punë më të kualifikuar për veshjet tradicionale autentike. Probleme që nga organizatorët mund të zgjidhen në të ardhmen.

Gjatë kthimit nga Kelmendi kafën e pimë në një nga lokalet e Tamarës, ku veç kënaqësisë së shijes së kafes dhe ujit të Cemit, shijua edhe atë pamje arkitekturore mjaft të bukur që të ofronte pedonalja e Tamarës, tashmë i shpallur fshat piktoresk e që po gëzon një vëmendje mjaft të veçantë nga pushteti vendor e qëndror, çka vihet re në punimet e stilizuara që po kryeshin përgjatë gjithë asaj qëndre tashmë aq të lakmuar nga turistët vendas dhe të huaj.

Kam marrë pjesë në shumë aktivitetet dhe kam përjetuar kënaqësi të madhe, por e them me bindje se Logu i Bjeshkëve me të gjitha risitë dhe mangësitë mbetet festa me më shumë pjesëmarrës nga të gjitha organizimet e rëndësishme në Malësi të Madhe e me gjerë.

DUKAGJINI DHE NATYRA

Monumentet e natyrës

Përgatitur nga Ing. Agim DARDHA

Sikur të kisha qënë në takim me perënditë dhe të kërkoja se si ta ndërtoja Dukagjinin, nuk do isha në gjendjen ti rendisja gjitha ato që Zoti ja fali kësaj treve. Një territor i ndodhur mes Alpeve të Ballkanit, që shtrihen nga një lartësi, që fillon nga 220 metra mbi nivelin e detit (Prekal) e lartësohet në drejtim të perëndive në lartasin mbi 2 570 m (Maja e Jezercës). Sipërfaqja e kësaj treve është rreth 607 59 km² brenda së cilës ndodhen mjaft Monumente Natyre, për të cilat po jap një përshkrim të shkurtër.

1. Ujëvara e Thethit

Ndodhet në afërsi të fshatit Theth, në lartësinë 900 m mbi nivelin e detit. Përfaqëson një ujëvarë, me lartësi rreth 30 m. Ajo ka pamje mjaft tërheqëse, sidomos në kohë me diell, kur piklat e ujit zërthejnë rrezet diellore, duke formuar ylberin shumëngjyrësh. Ka vlera shkencore, didaktike, estetike e turistike. Vizitohet duke ndjekur itinerarin Shkodër-Koplik – fshati Theth.

2. Vaskat e lumit të Kapresë

Vaskat ndollën në fshatin Nderlysa, në lumin e Kapres, këtu fenomenet e gërryerjes nga uji i rrëmbyer i lumit ka krijuar një panorama mahnitëse.

3. Ujëvara e Brashtës

Kjo ujëvarë ndodhet në fshatin Brashtë të Njësisë Administrative Shosh, me perimetër 215 m, me sipërfaqe 3 582 m²

4. Burimet e panjës së Tasit

Këto burime ndodhen në bregun lindor të lumit të Shalës, në mes fshatit Mushaj dhe Nderlysay, ujërat e këtyre burimeve janë me ujë të pijshëm dhe mjaft të pasura me kripëra minerale.

5. Bliri te ura e Shalës

Ky blirë ndodhet në fshatin Breg-Lumi të Njësisë Administrative Shale, është një drurë shumëvjeçare dhe në gjendje fitosanitare shumë të mirë.

6. Blirët e Lesniqes

Ndodhen në afërsi të fshatit Lesniqe, në stanet e Bratit, 1000 m mbi nivelin e detit. Përbën një grup drurësh me trung dhe kurorë të veçantë, me lartësi 20 m dhe diametër të trungut 1.6 m dhe moshë mbi 120 vjeçare. Ka vlera shkencore (biologjike dhe ekologjike), kulturore, didaktike dhe turistike. Mund të vizitohet sipas itinerarit qyteti i Shkodrës-Lesniqe.

7. Burimet e Okolit

Gjenden në Theth (Nikgjonaj). Monument i përfaqësuar nga burime ujore të mëdha karstike, që dalin pak metra mbi shtratin e lumit të Thethit, në kontaktin e shkëmbinjve gëlqerorë me rreshpet e paleozoit, përgjatë një sektori me gjatësi rreth 20 m.; në lartësinë rreth 900 m mbi

nivelin e detit. Krijojnë një mjedis shumë tërheqës. Ka vlera shkencore, didaktike, turistiko-ekonomike. Vizitohen sipas itinerarit qyteti i Shkodrës-Theth (Nikgjonaj).

8. Burimet e Kirit

Përfaqësojnë burime karstike të kontaktit tektoniko-litologjik. Ndodhen në lartësinë 400 m mbi nivelin e detit, në afërsi të fshatit Kir, të Njësisë Administrative Pultt. Dalin në një sektor që ka formën gati të një erashke, me gjatësi mbi 800 m. Prurja e tyre arin mbi 600 l/sekondë. Ujërat e tyre shënojnë pikënisjen e lumit të Kirit. Vizitohet sipas rrugës rurale qyteti i Shkodrës-fshati Kir.

9. Guri i Lekës

Përfaqëson një kreshtë dhe një greminë të formuara në shkëmb gëlqeror. Gjendet në lartësinë e rreth 1200 m mbi nivelin e detit, pranë fshatit Malagji, të Njësisë Administrative të Shoshit. Gjatësia e saj është mbi 900 m, ndërsa lartësia arrin disa qindra metra. Ka vlera shkencore (gjeologjike e gjeomorfologjike), didaktike, turistike. Vizitohet sipas itinerarit qyteti i Shkodrës-Shosh-Malagji.

10. Gështenja e Mguilit

Ndodhen në Njësinë Administrative te Pult, fshatin Mguil, në 700 m mbi nivelin e detit. Përbën një dru me trung dhe kurorë të veçantë (piramidale) me lartësi 20 m dhe diametër të trungut 1.1 m dhe moshë mbi 180 vjeçare. Ka vlera shkencore (biologjike dhe ekologjike), kulturore, didaktike dhe turistike. Mund të vizitohet sipas itinerarit qyteti i Shkodrës-Kir-Mguil

11. Fusha e Liqethit

Ndodhet në kreshtën e malit të Cukalit, 1200 m mbi nivelin e detit. Përbën një shpellë karstike të formuar në gëlqerorët e Kretës së sipërme. Është e gjatë 75 metra, e gjerë deri në 12 m dhe e lartë 31 m. Shpella ka konkrecione të shumta. Ka vlera shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike), didaktike, ekologjike dhe kulturore. Vizitohet duke ndjekur rrugën rurale qyteti i Shkodrës-Cukal.

12. Cirku i gropës së bukur të Jezercës

Njihet edhe me emrin Gropa e Jezercës. Gjendet në malin e Jezercës, më të lartin në Alpet Shqiptare (2694 m mbi nivelin e detit). I përket fshatit Theth, të rrethit të Shkodrës. Përfaqëson një cirk akullnajor. Ka formën e një gjysmë harku me gjatësi mbi 1.5 km. Në pjesën e hapur të tij ku ka depozitime akullnajore janë formuar 4-5 liqene të vegjël akullnajorë. Ka vlera shkencore (gjeomorfologjike e gjeologjike), didaktike, estetiko-turistike. Mund të vizitohet sipas itinerarit: rruga automobilistike Shkodër-Koplik-Theth dhe më pas merret rruga e vështirë këmbësore deri tek monumenti, rreth 1750 m mbi nivelin e detit.

13. Kanioni i Grunasit

Gjendet në fshatin Theth, Njesia Administrative Shalë, në lartësinë 700 m mbi nivelin e detit. Përfaqëson një grykë lumore në formën e kanionit të formuar nga veprimtaria gërryese e ujërave të lumit të Thethit, por edhe veprimtaria e proceseve karstike në shkëmbinj të gëlqerorë. Është i gjatë rreth 1.8 km, i thellë rreth 60 m dhe i gjerë rreth 4-6 m. Ka shpatë të thepisura. Në të njëjtën kohë përbën edhe një ekosistem interesant karstik. Ka vlera shkencore (gjeomorfologjike), didaktike e turistike. Vizitohet sipas rrugës rurale qyteti i Shkodrës - Theth-Breglumë

14. Liqeni i Pejës

Ndodhet në qafën e Pejës, në lartësinë mbi 1700 m mbi nivelin e detit. Është i vendosur në një cirk të madh akullnajor. Përbën një liqen akullnajor, me sipërfaqe rreth 10 ha. Ka ujë të pastër si kristali dhe të ftohtë. Gjatë dimrit ngrin në sipërfaqe. Është i pasur me një botë të gjallë të larmishme dhe formon një ekosistem interesant të liqeneve alpinë. Ka vlera shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, biologjike), estetike, didaktike, ekologjike dhe kulturore. Mund të vizitohet sipas itinerarit qyteti i Shkodrës-Theth-qafa e Pejës.

15. Liqeni i Jezercës

Ndodhet në bllokun e Jezercës, në lartësinë mbi 2100 m mbi nivelin e detit, i vendosur në një cirk të madh kompleks akullnajor. Përbën një liqen akullnajor me ujë të pastër si kristali dhe të ftohtë. Gjatë dimrit ngrin në sipërfaqe. Është i pasur me një botë të gjallë të larmishme dhe formon një ekosistem interesant të liqeneve alpinë. Ka vlera shkencore, estetike, didaktike, ekologjike dhe kulturore. Mund të vizitohet sipas itinerarit: rruga automobilistike Shkodër-Koplik-Theth dhe më pas merret rruga e vështirë këmbësore deri tek monumenti, rreth 1750 m mbi nivelin e detit.

16. Portat e Shalës

Gjendet në fshatin Breg-lumë, në Shalë. Përfaqëson një grykë të ngushtë lumore në formën e kanionit, të formuar nga gërryerja e ujërave të lumit të Shalës në shkëmbinj të gëlqerorë paleozoikë. Ka gjatësi 50 m, gjerësi 20-25 m dhe thellësi mbi 200 m. Ka vlera shkencore, didaktike e turistike. Vizitohet duke ndjekur rrugën rurale qyteti i Shkodrës-Theth-Breg-lumi, ose Shkodër-Kir-Ndreaj-Kodër Shengjergji.

17. Pragu i Kapreit

Ndodhet në afërsi të fshatit Nderlysay, në Shalë, 900 m mbi nivelin e detit. Përbën një bllok gëlqeror me moshë mesozoike të prerë nga lumi i Kapreit (degë e lumit të Thethit). Është i gjatë 900 m, 4 m i gjerë dhe 6 m i thellë. Ka vlera shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike), didaktike, ekologjike dhe kulturore. Vizitohet sipas itinerarit rruga rurale qyteti i Shkodrës-Theth-Breglumë.

18. Pisha Flamur e qafës së Pejës

Ndodhet në qafën e Pejës, 1700 m mbi nivelin e detit. Përbën një dru me trung dhe kurorë të veçantë (flamurit) me lartësi 20 m dhe diametër të trungut 1.6 m dhe moshë mbi 200-vjeçare. Ka vlera

shkencore (biologjike dhe ekologjike), kulturore, didaktike dhe turistike. Vizitohet sipas itinerarit: rruga automobilistike Shkodër-Koplik-Theth dhe më pas merret rruga e vështirë këmbësore deri tek monument.

19. Rrasa e Palajve

Përfaqëson një rrëpirë shkëmbore të shkallëzuar. Është formuar në shkëmbinj të gëlqerorë, pranë fshatit Palaj, Njesia Administrative Shosh. Gjatësia e saj është rreth 1 km ndërsa lartësia mbi 200 m. Është e pakalueshme. Në muret e saj ka zgavra e guva karstike, të cilat mund të vijojnë në shpella. Ka vlera shkencore (gjeomorfologjike e gjeologjike), didaktike dhe turistike. Vizitohet duke ndjekur itinerarin qyteti i Shkodrës-Shosh-fshati Palaj.

20. Shpella e Kataraktit

Gjendet në afërsi të fshatit Theth, Njesia Administrative Shale, në lartësinë 870 m mbi nivelin e detit. Njihet edhe me emrat ku thyen uji Qafën, Ujëvara e Grunasit dhe Shpella e Ujit. Është formuar nga karsti në shkëmbinj gëlqerorë. Është eksploruar nga speleologë të huaj të shoqëruar nga Gëzim Uruçi. Gjatësia arrin në 170 m. Ka galeri, zbritje e ngjitje, zgjerime e ngushtime, sifone me ujë etj. Ka vlera shkencore (gjeomorfologjike e speleologjike), didaktike e turistike. Vizitohet duke ndjekur itinerarin: Koplik-Theth-Grunas - Gropa e Boshit-Shpella e Kataraktit.

21. Shpella Gumnarit (Thethit)

Ndodhet në lartësinë 900 m mbi nivelin e detit, pranë fshatit Theth, Njësisë Administrative Shalë. Përfaqëson një shpellë karstike të formuar në shkëmbinj gëlqerorë. Ka gjatësi mbi 150 m. Ka ngushtime e zgjerime, labirinte e puse, mikroforma tërheqëse. Ka vlera shkencore (speleologjike, gjeomorfologjike e gjeologjike), didaktike, turistike. Vizitohet duke ndjekur rrugën automobilistike rurale Shkodër-Koplik-Bogë-Theth.

22. Shpella e Zhylës (Prekalit)

Ndodhet në qendër të fshatit Prekal, në krahun e majtë të shtratit të lumit Kirit, në lartësinë rreth 400 m. Kjo shpellë është 104 m e gjatë, përbëhet nga disa galeri, që ndërthuren me hapësira më të gjera. Është shtrati i një përroi nëntokësor, të përkohshëm, që derdhet në Kir. Eksplorimi është bërë nga speleologë të huaj dhe Prof. T. Ziu. Ka vlera shkencore, didaktike dhe turistike. Është mjaft mirë e ruajtur, por rrezikohet nga banorët vendas dhe pseudospeleologët e huaj. Kjo shpellë vizitohet po të merret rruga automobilistike Shkodër-Prekal.

23. Shpella e Majës së Harapit

Gjendet në lartësinë 840 m mbi nivelin e detit, në Theth. Përfaqëson një shpellë karstike të formuar në shkëmbinj gëlqerorë të Alpeve Perëndimore Shqiptare. Shpella është pranë majës së Harapit. Gjatësia e saj është 3 km, ka ngushtime, zgjerime, puse me ujë esifone. Gjerësia dhe lartësia më e madhe e zgjerimeve është 20-30 m. Ka mikroforma karstike. Mund të vizitohet nga speleologë sipas itinerarit qyteti i Shkodrës-Theth-Okol-Kroi i Shtradhës-maja e Harapit

HUMANIZMI I NJË MJEKJE ZVICERANE, MIKE E SHQIPTARËVE



Alfred Papuçiu

Duke lexuar Zhyl Vernin, që është shprehur aq bukur: “Kur nuk krijoj nuk ndiej jetë në veten time”, mendova t’ju sjell sot kujtimet e mia të paharruara për një mjeke humaniste zvicerane, me të cilën kam punuar vite të tëra. Prej vitesh kam ndarë me të dhe personelin human mjekues, mjekë dhe infermierë në Gjenevë, para fillimit të një konsulte, “kruasantin” (croissant) dhe kafen e mëngjesit, duke diskutuar lirshëm dhe si midis kolegësh, që na bashkon një qëllim: si të përmirësojmë bisedën me një pacient nga Shqipëria, Kosova apo nga viset, Maqedonia e Veriut, apo me bashkëkombës shqiptarë që janë vendosur në Zvicër, qoftë edhe përkohësisht. Kemi folur për atë gruan shqiptare që nuk dinte asnjë fjalë frëngjisht dhe dëshirën e saj për të kuptuar gjithçka nga biseda, për prindin e asaj fëmije që nuk ka konsultuar asnjëherë mjek në fshatin e saj, diku në Kosovë, për mungesë mjetesh dhe personeli mjekësor. Midis tyre, kam pasur rastin të marr pjesë dhe të diskutoj me doktoreshën humaniste zvicerane, Marinette Eÿss, një njeri i qetë, në pamje e ashpër, por tepër modeste, fisnike dhe e urtë, kur e njeh nga afër. Për të gjithë ata që kanë pasur fatin ta njohin, ajo nuk linte asnjërin prej tyre indiferent. Kureshtarë, njerëzore dhe e dashur, ajo vazhdoi në ravat e jetës, duke ecur në një “udhë” profesionale që dallohej nga autorësia e saj, për një trajtim të ri të sëmundjeve gjenetike, duke përfshirë edhe talaseminë, që është e përhapur sidomos në zonat mesdhetare: Greqi, Itali, Qipro, Shqipëri, Francë, Belgjikë, Britani e Madhe, Turqi, Indi, Singapori, por edhe në vendet arabe, si Dubai, Oman, Irak, Tailandë apo edhe në Kanada e SHBA, si rezultat i migrimit. Doktoresha Eÿss kishte aftësi të bashkëpunonte ngushtë dhe me kolegët e saj të spitaleve të tjera në Zvicër, por edhe jashtë, si për shembull edhe me profesorët shqiptarë të hematologjisë, Selaudin Bekteshin dhe Enis Boletinin. Ajo komunikonte edhe me profesorin e shquar francez, Robert Girot, lidhur me pacientët shqiptarë që kuronte në Departamentin e Pediatrisë së Spitalit Kantonal Universitar të Gjenevës. Kohët e fundit pata rastin të shfletoj letërkëmbimet e saj me prof. Enis Boletinin dhe me prof. Robert Girot. Ajo shquhej për

shpirtmadhësi dhe këmbëngulje për të trajtuar pacientët talasemikë me një terapi sa më bashkëkohore. Ajo ka shpëtuar shumë jetë fëmijësh dhe adoleshentësh që vinin nga kontinente të ndryshme, duke përfshirë edhe nga Shqipëria, Kosova dhe viset. Gjithçka që po shkruaj më poshtë është një nga mijëra dëshmitë, që mund të shkruheshin nga qindra njerëz që kanë biseduar dhe kanë ndeshur me këtë doktoreshë të jashtëzakonshme zvicerane.

Megjithëse i kisha shprehur disa herë dëshirën që të shkruaj për jetën e saj, ajo me modestinë që e karakterizonte nuk ka pranuar, pasi e quante veprën e saj si përkushtim modest ndaj profesionit, të cilin e kishte pranuar me dëshirë.

Marinette Eÿss lindi në vitin 1930, në një familje modeste zvicerane dhe shumë shpejt prirja e saj ishte mjekësia, studimi i sekreteve të trupit të njeriut dhe gjetja e rrugëve për të ulur sadopak dhembjet e atyre mijëra të sëmurëve, që prisnin diçka më të mirë. Ajo me punën e saj si mjeke, qysh e re fitoi besimin e ekipit tjetër mjekësor, si dhe të pacientëve të shumtë. Komunikonte me ta me një gjuhë të thjeshtë, në frëngjisht, gjermanisht, italisht apo anglisht, kur kishte të bënte me pacientë dhe me gjuhën mjekësore të mirëfilltë me kolegë zviceranë apo të huaj. Shumë shpejt mori titullin e lartë “doktor” në mjekësi dhe në vitin 1973 krijoi Qendrën e Hematologjisë dhe Onkologjisë Pediatrike, në Spitalin Universitar të Gjenevës. Në këtë spital kanë kryer studimet e tyre universitare dhe pasuniversitare edhe shumë mjekë shqiptarë nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut, që sot kanë edhe titullin “profesor” në mjekësi. Sot kujtohet akoma me respekt nga ish-kolegët e tij në Spitalin Kantonal Universitar të Gjenevës, profesori i dëgjuar shqiptar, Isuf Kalo, i cili ka qenë për një kohë të gjatë edhe funksionar i lartë i OMS-it në Kopenhagë. Kardiologjia Adriana Keta, pas aftësisht në Spitalin Kantonal Universitar të Gjenevës, ka dhënë përvojën e saj të fituar në Zvicër, por edhe në Francë, në Spitalin Kantonal të Lozanës, si dhe konsulente në spitalin me famë botërore të Zyrihut. Ajo tashmë ka hapur kabinetin e saj. Mjekë të tjerë nga Shqipëria dhe Kosova janë aftësuar në Spitalin Universitar të Gjenevës, diabetologë, dentistë, gjeneticienë etj., si dhe një numër infermierësh që kanë marrë diplomën në shkollën e lartë “Bon Secours” në Gjenevë, partnere e privilegjuar e Spitalit Kantonal Universitar të Gjenevës. Roel dhe Jorida Zoga, së shpejti, përveç perfeksionimit në fushat e tyre të mjekësisë në Lion për neurologji dhe laborator për talaseminë, do vijnë edhe në Gjenevë.

Doktoreshë Eÿss, ashtu si edhe profesor Jean-Philippe Assal që është njëkohësisht anëtar nderi i Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq dhe ka qenë drejtor i një qendre të OBSH-së në Gjenevë, prof. Afksendyos Kalangos, kryekirurgu i famshëm botëror në shërbimin e kar-

diologjisë vaskulare (ka realizuar me shumë sukses edhe operacione të zemrës të pacientëve shqiptarë dhe ka shpëtuar mëse një herë jashtë territorit spitalor me përvojën e tij shembullore, një paciente shqiptare që pati një vdekje klinike), kanë pritur dhe formuar shumë mjekë shqiptarë dhe kanë bërë të mundur ardhjen në Gjenevë edhe të personelit tjetër mjekues shqiptar. Ndjenjat e tyre dhe respekti për shqiptarët kanë bërë që shkëmbimet dypalëshe në fusha të ndryshme të mjekësisë bashkëkohore të vazhdojnë.

Doktoreshë Eÿss, siç e quanin kolegët e saj, si dhe pacientët dhe prindërit e tyre, ishte një nga pionieret e mjekësisë moderne zvicerane, por modestia, urtësia dhe krenaria e saj bënë që ajo shpesh çdo arritje të saj ta kalonte në heshtje... Tani, ajo nuk mund të më ndalojë ndoshta me shikimin e saj me buzëqeshje, por edhe njëkohësisht qortues: “Të kam thënë të mos shkruash për mua, se gjithçka që kam bërë ka qenë e zakonshme dhe gjithë personeli mjekësor ka dhënë ndihmesën e vet”. Unë e mora këtë guxim, pasi ajo është larguar nga kjo jetë në moshën 83-vjeçare. Ky është një homazh që i bëj një mjekeje zvicerane, por edhe mike e shqiptarëve, që u dha gëzim dhe optimizëm për jetën qindra e qindra vogëlushëve dhe adoleshentëve, si edhe prindërve të tyre, qofshin këta zviceranë apo të huaj, por me sigurinë se e ardhmja e tyre do të ishte më e mirë. Ajo iku ashtu e heshtur, me vështrim të patronditur në çastet e fundit, e urtë, pa u qarë një herë. Ajo iku, por qindra e qindra pacientë të saj, që tani janë në moshë madhore, zviceranë dhe të kombeve të tjera, që kanë zgjedhur Zvicrën si tokë qëndrimi edhe për disa vite, do ta kujtojnë doktoreshë Eÿssin si një qenie të hijshme, të gjallë, me fytyrën që i shkëlqente para çdo pacienti. Personalisht, do të kujtoj ditët që kemi kaluar bashkë, jo vetëm kur ajo ushtronte profesionin e mjekes hematologe, por edhe kur ajo doli në pension. Kujtonim çastet e vështira, por edhe gëzimin e saj kur pacienti bëhej më mirë ose shërohej fare, në sajë të teknikave të reja në mjekësi. Kujtonim pjesëmarrjen e saj në programe kërkimore për transplantimin e palcës së kockës te fëmijët talasemikë. Çdo herë që vija nga ndonjë udhëtim jashtë shtetit, nga konferencat ndërkombëtare për talaseminë, më dëgjonte me vëmendje. Ashtu si ai profesori i nderuar shqiptar, Aleko Vesho, që megjithëse kishte mbushur 80 vjet, i shprehej një mikut tim mjek që t’i dërgojë botime të reja për talaseminë, edhe ajo ngaqë nuk kishte mundësi të lëvizte më, i priste si ujët e pakët botimet në përgjithësi për hematologjinë, por në veçanti për talasemikët. Me mijëra faqe të shkruara nga dora e saj, nga përvoja e pasur e jetës mjekësore. Shumë nga ato nuk i botoi, pasi nuk i quante si vlera të krijuara prej saj. E gjeta me lot në sy kur shfletonte së fundi revistën me prestigj “American Journal of Medical Genetics”, ku ishte

botuar një punë kërkimore e saj në fushën e hematologjisë. Kolegët nuk e harronin, por gjithmonë merrnin mendimin e saj, me gjithë moshën e thyer. Botimi i saj, së bashku me kolegun, docentin Pierre Eacker, “Regresi i insuficiencës kardiake pas administrimit ambulator intravenoz të Desferalit në Talaseminë Majore” është një udhërrëfyes dhe një dëshmi e punës së saj me pasion, e ndjekjes me përsosmëri edhe të pacientëve shqiptarë. Kishte qenë anëtare e Byrosë së Ligës kundër kancerit të Gjenevës, drejtuese e Departamentit të Pediatrisë në Qendrën Mjekësore Universitare të Vodit (CHUV), ku kanë punuar edhe punojnë akoma mjekë shqiptarë, që kanë bërë emër në fushën e tyre të specialitetit mjekësor. Ka qenë konsulente e spitalit të dëgjuar “La Tour” në Gjenevë, si dhe ka marrë pjesë në shumë programe kërkimore për transplantimin e palcës së kockës në Europë.

Doktoreshë Eÿss, duke e parë pasionin tim për të mësuar më tepër për talaseminë, më tha një ditë pas leximit të dy librave të mi dygjuhësh, frëngjisht dhe shqip, “Meditime për shqiptarët, Evropën dhe Kombet e Bashkuara”, si dhe “Nxënësjat e etur e gjuhës romanshë”, “Toena”, ku unë kam përfshirë përveç tregimeve, skicave dhe refleksioneve, edhe artikuj të mitë lidhur me hapat në luftën kundër talasemisë: “Mesazhet lidhur me mjekimin klinik të talasemisë janë të shumta dhe premtuese. Shkencëtarët punojnë në këtë drejtim, por realizimet e tyre do të varen edhe nga pranimi i një mjekimi klinik të përshtatshëm nga ana e vetë pacientëve talasemikë, për të arritur pastaj te mundësia e një kurimi më të efektshëm”. Ajo i jepte rëndësi edhe informimit të familjeve që kanë predispozicion të kenë paraardhës me gjenin e talasemisë, depistimit të tyre me anë të anketave në familje, gjatë konsultave mjekësore të përditshme apo paralindjes, çka ndikon në parandalimin e sëmundjeve te fëmijët e ardhshëm; shtronte si domosdoshmëri diagnozën prenatale, që falë përparimeve të teknikave të marrjes së materialit gjenetik dhe biologjisë molekulare, është zbatuar që nga vitet 1970.

Një ditë, duke kërkuar në dosjet e saj të panumërta, ku kishte shkëmbimet e saj me mjekë të vendeve të ndryshme, më nxori edhe letërkëmbimin me prof. Enis Boletinin dhe nëpërmjet tij, me profesor Selaudin Bekteshin, lidhur me trajtimin klinik fillestar të një pacienti shqiptar në klinikën e saj. Bile, më tregoi edhe letërkëmbimin me profesorin e dëgjuar francez, Robert Girot, një nga njohësit më të mirë të talasemisë në botë. Ai i shkruante se prof. Enis Boletini kishte komunikuar me të lidhur me mjekimin e disa pacientëve shqiptarë dhe e quante me interes bashkëpunimin me atë mjek shqiptar, që e njihte shumë mirë problemin e talasemisë. Doktoreshë Eÿss kishte miqësi me të, ndaj konsultojë gjithmonë edhe për pacientët shqiptarë që

HUMBËN JETËN DY MESHTARË ITALIAN, QË PUNUAN NË BASHKËSINË DUKAGJINASE


Me datën 7 e 8 shtator 2019 ndëruan jete dy meshtar italian, Dom Mikele Braga dhe Pader Antonio Bozza, të urdhrat Dehonian.

Dom Silvo ndërroj jetë në vendlindjen e tij, Brescia; ndërsa Pader Antonio Bozza, në spitalin Nënë Tereza në Tiranë.

Dom Silvio Braga lindi në Brescia, në Itali, me 4 qershor 1942. Pas disa udhëtimeve humanitare në Shqipëri, i shtyre nga dashuria e zotit dhe ndaj të afërmeve, iu bashkua jetës meshtarë. Vëllai Mikele Braga ishte famullitar i Shllakut dhe Jubanit, ku në vitin 1993 transferohet në Shkodër duke braktisur jetën e familjen e tij dhe vendoset në Shkodër. Me datën 18 dhjetor 1994 shugurohet meshtar në katedralen e Shën Shtjefnit nga Monsinor Frano Ilija duke thënë me gëzim "Krishtit e Shqipërisë po i kushtoj jetën time!" Deri në vitin 1996 shërbeu meshtar në Razëm e Koman, ndërsa nga 1 shtatori 1997 deri në shtator 2015 ishte famullitar në Ashtë e Kosmaç. Në fund të shtatorit 2015 lar-

gohet nga Shqipëria për shkak të gjendjes shëndetësore dhe transferohet në Itali. Dom Silva shquhet për urtësinë e tij kur nisi punën në zonat me varfëri të madhe dhe, falë njohjeve të tij në Itali, punoi për ngritjen e kishave dhe ndihmën e madhe që dha në njohjet e të rinjve në mësimin e gjuhës italiane e binjakëzimin e famullive me Italinë. Urtësia e tij dallohej në shpërndarjen e shpresës gjate dhënies së sakramenteve duke udhëtuar drejt çdo fshatit të famullisë së Komanit, në fshatrat Karne, Palaj, Qarret, Vile, Telume Dushman e Toplanë. Punoi fort me të rinjtë dhe ka meritë të madhe në ngritjen e kishës në Kosmaç, ku besimtarë e ardhur nga Shllaku dhe zonjat e tjera kërkuan ngritjen e kishës. Falë bashkëpunimit me familjet e Shllakut që jetonin në Kosmaç, bëri të mundur ndërtimin e kishës. Funerali mortor u mbajt nga Ipeshkvi i Brescias Monsinor Pirantonio Tremolada.

Pader Antonio Bozza lindi me 31 korrik 1945, në Itali. Ai ka ardhur në Shq-



ipëri në shtator të vitit 2000, në bashkësinë e Gurëz në Laç të Milotit, ku nisi dhe jetën meshtarake, pas të cilës transferohet në famullinë e Boriçit. Në fillim, nisi punën për të mësuar gjuhën shqipe ku vështirësitë ishin të mëdha në shenjen e meshës së shenjtë, ku në një kohë të shpejtë arriti të flasë lirshëm dhe të komunikojë me banorët. Gjatë jetës së tij meshtarake në Boriç ishte dhe krahu i djathtë i at Mario Bosios, misionar në atë kohë duke ndihmuar formimin e seminaristëve. E kaloi jetën e tij misionare, ku shquhej për njohje të shumë gjuhëve e

tare, punoi për ngritjen e infrastrukturës së kishës katolike. Falë ndihmave të siguruar nga bamirësit katolik bëri të mundur ndërtimin e kishës në Vrakë, në Boriç e varrezat përballë kishës, si dhe në mirëmbajtjen e kishës së Shën Ndout e Shën Gjinit, që është një nga vendet e njohura për zhvillimin e krishterimit e vend pelegrinazhi. Punoi shumë vitet e fundit për përkthimin e materialeve historike për arkivin e kishës katolike, ku la një bibliotekë të pasur arkivore me pamje filmime e përkthime. At Antonio ndërroi jetë në spitalin Nënë Tereza në Tiranë, me 8 shtator 2019. Trupi i pa jete ishte i pranishëm në kishën e Boriçit, katedralen Shën Shtjefni e kishën e Gurësit në Mirditë. Mes shumë besimtarëve, ceremonia e meshës së shenjtë u celebrua nga Monsinor Frano Kulli Ipeshkëvi i Sapes), Gjergj Meta (Ipeshkëvi i Mirditës) e Monsinor Angjelo Masafra (Ipeshkvi Shkodër-Pult). Në këtë ceremoni ishin të pranishëm vëllezërit dhe meshtarët Dehonian.

Krishti ju paste në Parris!

Pëgatiti, Zoje Shpendi, Marie Marshi, Elton Zojza, Tom Shpendi e Zef Nika



ajo kuronte me tepër përkushtim e dashuri. Prof. Robert Girot ka shumë botime për talaseminë. Ai tashmë është një nga bashkëpunëtorët më të njohur të Federatës Ndërkombëtare të Talasemisë (TIF), që kohët e fundit i ka zgjeruar kontaktet me Ministrinë e Shëndetësisë, me mjekët tanë hematologë dhe me shoqatën shqiptare të luftës kundër talasemisë. Presidenti i saj, i ndjeri Musa Zenelaj, ishte një anëtar i TIF me të drejtë vote, midis shoqatave të vendeve të tjera anëtare.

I kujtoja dr. Eysse se ajo ishte gjithmonë e pranishme në shërbimin e hematologjisë dhe rrezatonte akoma me këshillat e saj atje. E kuptonte se i jepja kurajë dhe i vinte keq se, për shkak të sëmundjes së saj, nuk mund të ishte më e pranishme atje; megjithatë, shprehte një kënaqësi kur e cilësonin akoma si të domosdoshme në shërbimin hematologjik. Bisedonim në apartamentin e saj në Shampel të Gjenevës, tepër modest për një mjekë të njohur si ajo, me piktura të shumta, dhuruar nga dashamirës të saj. Më tregonte për pasionin e saj qysh në rini për librat, për pikturën, për udhëtimet, për dëshirën e shprehur nga një qytetar belg, mik i saj, për t'u vendosur në vilën

e tij, diku në rrethinat e Brukselit...Ajo, megjithëse kishte mbetur mik me të, nuk kishte pranuar të largohej nga shërbimi hematologjik pranë Spitalit Universitar të Gjenevës, pasi aty ishte kënaqësia, jeta e saj si mjekë. Kujtonte udhëtimet e saj në Europë etj., shërbimet lidhur me transplantimet, bashkë me mikeshën e saj të vjetër, Karolinë Porcher. Kujtonte ato net pa gjuhë të mikeshës së saj, Roza, e cila i qëndronte pranë, e qetësonte, i jepte pak e nga pak për të ngrënë dhe ia ledhatonte flokët e saj të bardhë. Disa kohë më parë, pasi pa librat e mi dhe botimet e shkrimtarëve shqiptarë që i kisha dhuruar, apo diskutim me muzikë shqiptare të realizuar në Festivalin Folklorik shqiptar nga miku im zviceran, Marcel Cellier, fitues i Oskarit për muzikën e tij, ajo më tha: "Kam letra shqip nga pacientë shqiptarë, por siç e di, unë shqiptoj vetëm disa fjalë shqip: 'Mirëdita', 'Si ndiheni', 'Faleminderit', 'Mirupafshim' dhe disa fjalë të tjera. Do të doja të mësoja më tepër". Unë e dija se gjendja e saj shëndetësore nuk e lejonte të bënte një sforcim të tepërt, por për ta qetësuar, i përgjigjesha: "Do ta mësojmë bashkë pak e nga pak".

Më lejoni t'u tregoj një kujtim të bukur dhe të paharruar për doktoreshën Eysse.

"Mbrëmja e asaj të shtune te "Victoria Hall", salla më me prestigj në Gjenevë ku shfaqen operat, ishte e mrekullueshme. Çasti më prekës ishte kur orkestra, nën tingujt e "Ditëlindjes së gëzuar" i bënte thirrje një gruajë të moshuar, serioze dhe që nuk flet shumë, por ka një zemër dhe ndjenja njerëzore të jashtëzakonshme. Quhet Marinette Eysse, por të gjithë e thërrisin doktor Eysse. Ajo u emocionua kur Natalia i dha një buqetë të madhe me lule dhe e përqafoi fort si nënën e saj, shenjë e mirënjohjes për vitet e një jete të lumtur, në sajë të kujdesit të treguar nga doktoreshë Eysse. Ajo vazhdonte ta mbronte atë dhe Natalia e adhuron me një pasion të jashtëzakonshëm. Ajo u përgjigj me shumë modesti, kur kolegu i saj më i ri fliste për jetën e saj në shërbim të qindra e qindra njerëzve.

Ajo ka punuar qysh prej afro tre dhjetëvjeçarësh në spitalin e fëmijëve në Gjenevë. Ka parë të kalojnë para saj fëmijë që vuanin, që luftonin për një jetë më të qetë e me më pak halle, që diti t'ua ulë dhimbjet; ajo ka parë fëmijë që në fillim kishin frikë nga spitali dhe analizat, që vinin nga zona të thella të Kosovës apo vise të tjera, por me butësinë e fjalët e saj, mundi t'i bindë për dobinë e trajtimit. Së

bashku me ekipin simpatik dhe kompetent të hematologjisë, ajo bënte gjithçka për t'u kujdesur dhe shëruar fëmijët e prekur nga sëmundjet imunodeficitare etj. Shpesh qëndronte vonë në spital, pranë fëmijëve të sëmurë; diskutonte me ta dhe gjente ilaçin më të mirë duke u konsultuar me kolegët e tjerë specialistë, që përfaqësojnë një ekip kompakt. Megjithëse e kishte kohën shumë të zënë, ajo ishte gjithmonë e gatshme t'i dëgjonte. Jepte mendimin e saj dhe bashkëpunonte me shoqatën ARFEC në Gjenevë, që organizon shumë veprimtari për fëmijët e sëmurë, ekskursione në Zvicër, Francë, kampe pushimi, udhëtime tek Eurodisnei etj..

Mbrëmja te "Viktoria Hall" do të mbetet e paharrueshme për të gjithë ata që morën pjesë dhe admiruan gjithashtu orkestrën e artistëve të Lozanës. Ishte një kujtim i bukur për punën e përkryer që doktoreshë Marinette Eysse ka bërë në shërbim të njerëzve, të fëmijëve dhe të adoleshentëve zviceranë, shqiptarë, arabë, italianë, britanikë, portugezë e kombeve të tjera, që e përbëjnë Gjenevën multietnike.

U RRËZUA SHQIPTARI MË I FUQISHËM I BREZIT TË TIJ

Mirash Vuksani (Shala)

Prele Milani

Me datë 5 shtator 2019, n u rrëzua me “tuç” njeriu më i fuqishëm i tapetit, që mbretëroi me pallën e despotit për një dekadë në fronin e mundjes shqiptare. Klasiku i mundjes klasike, ahu i vjetër dhe madhështor u shemb e ra hordovel, duke lenë pa mriç logun epik të kampionëve të lavdishëm të tapetit shkodranë. Njeriu historik, që nuk u tund nga as një vampir në vitet 60-70-të, të shekullit të tij më në fund u dorëzua përpara një “amazonë” që e dashuroj me xhelozë për një jetë të terë. Mortja shamizezë erdhi natën për terr dhe e shytoj brinjë më brinjë për të mos u ngritur kurrë më dragoin triumfues të qindra mejdaneve që nuk e dinte se çfarë është tuta! Pas 84 vitesh Mirash Vuksani mori udhën për në jetën e pasur për të pushuar i qetë në amshim, atje ku prehen lokja dhe tata që na dhuruan këtë **Gurë të çmuar**. Për të pushuar atje në Perandorinë e të shumtëve, ku të gjithë në kalimtarët e kësaj bote e kemi nga një biletë falas.

Vdekja e kampionit tonë të madh nuk qe tragjike as e pa pritur, ligjësitë dialektike të moshës e s’postuan fillimisht nga fronti, pastaj nga tapeti dhe tani nga jeta.

Mirash largimin tënd nga kjo botë që më shumë e deshe se të përkëdheli e prita me pikëllim të thellë se të kisha idhull!

Mirash, largimin tënd të natyrshëm nga kjo botë e priten me dhimbje e pikëllim qindra e mijëra, shqiptarë që të njohën, të deshën e te adhuruan nder vite!

Vdekja e juaj lëndoi një armatë të shkëlqyer të njerëzve të sportit, me cilët u rrite, u burrërove, luftove, ndave gëzimet, hidhërimet dhe shkruat së bashku historinë.

Klubet emblematike “Vllaznia” e “Partizani” në mesditën rrezatuese të 5 shtatorit 2019, krejt pa prituri u eklipsuan nga shuarja e yllit të tyre historik. Mundja klasike shqiptare në sensin figurativ, sot humbi një trim romantik, në sensin sportiv humbi një hero të pa zëvendësueshëm; ndërsa familja, miqësia dhe shoqëria humben njeriun e ndershëm të sinqertë, burrërore dhe te dashur.

Biga e Gimajve. Jezerca, maja e Zezë e simotrat e tyre mëngjesin e 5 shtatorit i mbuloj një tis i hollë mjegulle në shenjë zije për bjerrjen e lodëtarit më të famshëm të bjeshkëve, të cilat krenoheshin me pjellën e tyre dashurore. Sikur kreshniket e lashtë të ishin rrokur në një log livadhi me Mirash Vuksan (Shalën) shumë nga ata do të kishin mbetur pa lavdinë e tyre shekullore, pasi djaloshi i kohërave moderne ishte po aq i zoti sa të sfidonte çdo legjendarë.

Mirash, sot u largove nga ne i thjeshtë, njerëzorë, madhështor, hije rëndë, argat i djersitur, mundimtarë i madh i dhe i pa vlerësuar siç meriton një kampion, që na dhuroj shekull, që sa po shkoi, që ndoshta duhen shumë e shumë vite të lindë edhe një i tillë.

Mirash, sot u largove i heshtur, zemër



bardhë, kolos i pa brenga inatçare për ato që meritoje që nuk ti dhuruam dot.

Mirash, sot u largove si ka hije një burri bujarë duke lënë portretin tënd historik në panteonin e më të mëdhenjve të sportit shqiptarë.

Mirash, sot po largohesh i veshur me aureolën e gjeneralit që fitoj gjithçka i stolitur me një tufë epitimesh të merituar si “Legjenda e mundjes klasike”, “Gladiator i tapetit”, “Mbreti i vjetër”, “Arusha e Maleve”, “Dreri i veriut”, “Vampiri i tapetit”, “Herakliu dukagjinas”, “Dragoi i Shalës”, “Kompresori Skënderbegas”, pasi për 30 sekonda frynte çdo top futbollit.

Duke lënë në një anë epitimet dhe duke u kthyer te historia, e cila na tregon me gisht se, Mirash Vuksani la pas 10-të tituj kampion individual dhe ekipor të shartuar me disa kupa.

Mirashi i madh, ka mposhtur çdo kundërshtarë në pedanen e tapetit aty ku shemben dhe lartësohen sovranet dhe shkruhet historia, e cila kampionëve u vjen pas.

Kampioni botërore, gjigandi Guriç Gjorgji (14kg më rëndë), që pati fituar vetëm me një pikë diferencë pas atij dueli historike të zhvilluar me 15 korrik 1961 në Durrës, do të shprehej: “Kundërshtari im i sotëm, Mirash Vuksani është mundësi më i fuqishëm që jam ndeshur dhe kam pare ndonjë herë”!

Meush Marjan, kampion absolut i Rumanisë u detyrua me hidhërim të thellë të puthte tapetin dy herë radhazi në dy sfida, në maj të viti 1971, me shqiptarin që punonte në fermë e ky luftonte me luan profesionit.

Nën kampionin evropian i peshës super të rëndë, Nikola Monea, i famshëm për shkathhtësinë, brutalitetin dhe dinakërinë dhe fitoret që vinin varg, u shkapërderdh si gavixhi, kur i dalin rrathët përpara Mirash Vuksan Shalës.

Njeriut, që ujkon e renë në kurthe e përzuri për fyti dhe solli gjallë në banës! Njeriut që pas alarmit luftarak nga reparatin ushtarak deri në qendrën e zjarrit për 15 km e mbajti mortajën 187 kg!

Zoti i dhuroi bujarisht gjithë atë fuqi motorike, por as një herë nuk u mburre, nuk demonstroi, force as prepotencë ndaj askujt, madje duroj dhe toleroj edhe ndaj atyre që mund ti gremiste, si luani mizat me bisht.

I dashur, zemër bardhë, babaxhan dhe mësues shembullor ishte Mirashi dhe mbeti gjithnjë me të rinjtë e tapetit – “Pasha Zotin më dhimben me i shtrydhë, është gjynah, është gjynah me i sakatua thoshte;- Vuksani për shumë mundës, me te cilët shorti e detyronte te ndeshje”.

Mirash i dha gjithçka sportit shqiptarë dhe materialisht nuk gëzoi as një pension dinjitoz. Dinjiteti njerëzor, burrërore nuk e lejoj kurrë të ankohej, as të trokasë

në asnjë zyre shtetërore as me përlujë, as duke rrahur gjoksin se kush jam unë. Shteti koprrac dhe pa dinjitet edhe me pesë pare që i kurseu nga ju e shokët tuaj mbeti se mbeti rrjepacak dhe pa brekë.

Me 22 shkurt 1964, Vuksani mori titullin “Mjeshtër i sportit”, pas disa vitesh plot suksese shkëlqimtare mori titullin “Mjeshtër i Merituar i Sportit”, po ashtu nga Klubi shumë sportesh “Vllaznia”, është vlerësuar “Mundës i shekullit”.

Në dekorimet, me rastin 100 vjetorit të Klubit “Vllaznia” as kush nuk u kujtua për Legjendën e vjetër! As kush nuk u kujtua tash 20 vjet që trajtonte me pension të veçantë!

Tani është tepër vonë edhe po betë dhe ndonjë “mrekulli” ua rritë dreqi nderën! Korabi, Tomorri apo maja e Arapit shihen vetë, poetet nderojnë veten e vet po shkruan për madhësinë e tyre pasi ato janë poema të madhëruara. Pushtetarët dhe zullumqaret parasë që pinë një shishe verë dhe që kushtonte sa pensioni juaj vjetor, dhe që shpenzojnë hoteleve luksoze për dy javë me të dashurat e tyre sa more ti pagë një jetë të terë.

Ju të dehur nga qejfi i shfrenuar i pranicës dhe megalomania e pushtetit që pretendoni se, na dhuron shiun e diellin, blini e shitni tapi e tituj nderi, mos harroni se do ngordheni sa po lëshoni kolltukët, që haram i paçi.

Megjithatë arritjet sportive dhe trashëgiminë që la pas, “për Mirash Vuksanin u zhvilluan në një ceremoni private e denjë si e ka traditë Dukagjini e Shkodra, por për faqe “të bardhë” u la në harresë nga çdo institucion.

Mirash Vuksani dhe klani i racës së tij kampione nuk vdesin pasi ata i përkasin historisë. Lum kush vdes dhe i përket historisë si Mirash Vuksani!

Le të jetë ky shkrim një lule dhimbje dhe respekti mbi varrin tënd!

Një shërbim i largët më privoj nga ceremonia e lamtumirës se fundit!

Pushofsh përjetësisht në paqe o mbreti ynë i pa harruar!



Mirash Vuksani, i pari nga e djathta në të majtë, në rreshtin e dytë

PËRSE LOTOJNË?!

LOTOJNË NJERËZIT?

Lotët luajnë një rol shumë më të rëndësishëm nga sa shkencëtarët besonin prej shumë kohesh. Shkencëtarët nuk dinë ende gjithçka për lotët dhe nuk kuptohen arsyet për se çajmë.

Charles Darëin -“afirmonte se lotët emocional nuk kishin as një përfundim”. Dhe përsëri sot, afro 150 vite më vonë, ato mbeten një mister drithëruer i trupit njerëzor. Megjithatë disa specie qajnë siflex në përvijim të një dhimbje ose të një ngacmimi; njerëzit janë të vetmit që qajnë (që lotojnë) për arsye sentimentale (ndjenjash).

A janë lotët çështje emocioni?

Prej kohesh studiuesit nuk priren (merren) aq me emocionet se sa me proceset fiziologjike, që duket se nuk u interesojnë....? Prof. Eingerhoersfamozi Tibourg Holande. -Për sa i takon kësaj çështje (lotimit), theksonte, të qarit tejkalon shfaqjen e trishtimit. LOTET rrjedhin për trishtim, por dhe për një ndjenje të thellë empatie. Pra, surpriza kush nga zemërimi, emocioni; -emocioni i të parët me sy, kur ka dashuri, mund rrjedhin lot mallëngjimi. Prej shekujsh mendohej se lotët e kanë prejardhjen nga zemra.

Në shekullin XVII, supozohej se pikërisht dashuria, bën që të ngrihet temperatura e muskulit të zemrës, që çonte në ngrohjen e lëkurës dhe duheshin lotët për të freskuar, në të njëjtën kohë ngrihej deri në kokë, për tu kondensuar në sy, para se të transformohej në lot.

E qara a është mekanike?

Në vitin 1662, shkencëtari Danez, Niels Stensen theksoi se: -lotët kishin te vetmin objektiv lubrifikimin (pastroimin) e Syrit dhe Prof. Vingerhoets hodhi 8 (tete) teori, disa krejt absurde, ku njëra prej tyre evoluoi deri në 1960, ku shprehet, se qenia njerëzore zbrit deri te shenja ujore dhe lotët na lejojnë të kujtojmë ujën e kripur, ku jetonim.

Në vitin 1985, Eilliam Frey hodhi idenë, se lotët (të qarit) largon helmet që përmbahen në gjak dhe në mënyrë të veçantë në periudhën e stress-it,

Lotimi sinjalizon prekshmëri (Vulnerabilitet)

Provat e grumbulluara në favor të hipotezave më të besueshme, dhe kontaktin njerëzor e lidhja sociale, që në moshë të sa po lindur, kur dalim në këtë botë si qenie njerëzore qajmë-lotojmë- dhe që në moshë të re qajmë, që të vendosim një raport me të tjerët dhe prandaj e qara tregon paaftësinë fizike që ka qenia jone, për të jetuar e vetme. Pra, sinjalizon friken e vet-

misë, shpjegon Prof. Jonatan Rottenberg -Universiteti Florida e Jugut.

Në një studim të kryer në vitin 2016, kërkuesit kanë zbuluar se lotët krijojnë për dhembshuri (mëshirë). Pasi paraqesim fotot e një personi duke qare ato janë deklaruar më në faze, se pa lot. Shkencëtarët kanë zbuluar, se përbërja kimike e lotëve emocional është e ndryshme nga lotët që ngacmon prerja e qepës. Element të tjerë ndërtues baze të lotëve janë- enzimmat, lipoidet, metabolit dhe elektrolit, lotët emocional kanë një sasi më të madhe proteinash, diference, e cila rrit viskozitetin.

Pra, ato do të aderojnë (ngjitësen) më mirë, më lehtë me lëkuren, dhe kullojnë më lirisht.

Lotët sinjalizojnë

Prekshmërinë (vulnerabilitetin) dhe dëmtimin një dimension human; në zonën neuronale të trurit të personave të mallëngjyer sikur përjetohet një situatë, shpjegon Michael Trimble

Imunolog-Londerku, në një moment preciz të historisë së evolucionit, lotët shkaktohen nga shpërthimi i empathi-s dhe dhembshurisë, thekson teoria e altruizmit.

Një teori thekson dhe rolin ngushëllues dhe manipulues të lotëve. Studiuesit, tregojnë se bebet qajnë për të arritur atë, që dëshirojnë, gjë që mësohet lehtë, me vetëdije ose jo...

E qara neutralizon zemërimin e një mënyre shumë efektive, shpjegon Jonatan Retenberg. Lotët rrjedhin nga grindjet midis të dashuruarve, pikërisht kur pranojnë fajësinë dhe kërkojnë falje. Sipas një studimi të publikuar në revistën “shkence” shumë e mediatazuar përbërja kimike e lotëve të femrave ul eksitim seksual të burrave, 24 burra që nuhaten erën e lotëve femërore deklaruan se kanë provuar me pak eksitim seksual, para një pamje lotues të femrës... dhe tek 50 burra të tjerë pamja lotues e femrave ka ulur nivelin e testosteronit pikërisht në pështyme (salive) në mënyrat e krahasueshme me ato që kishin marr një solucion kripor.

Jashtë anekdotave të paverifikuara shkencërisht, njeriu është e vetmja qenie që qan emocionalisht duke shprehur -mërzi, trishtim, ose gëzim siç thotë populli -u shkri në vaj prej gëzimit, qau me lot -

Ne kemi tre lloj lotësh: -lot bazal, lot emocional dhe lot reflektim.

Lotët bazal prodhohen për të pas-truar dhe mbrojtur syrin dhe prodhohen sa here lëvizim kapakët, qepallat;

Lotët reflektive prodhohen nga ngacmimi ose nga qepet, nga lëndët e huaja, inflamacioni, alergjia e të tjera.



Për fëmijët në “Human Natyre” 2018 janë hedhur katër hipoteza për lotimin:

1. Lotët veprojnë si një thirrje për të ulur rrezikun që i kërcënon nga vetmia dhe abandonimisi dhe mungesa e kontaktit fizik me nënën.

2. Lotët janë tregues sigurie, tregojnë për formën fizike të fëmijës dhe për pasojë ul rrezikun në një ambient të pasigurt të fëmijës.

3. Të qarat tek fëmijët latent (të muajve të pare) u sjellin në mendje prindërve rrezikun e grabitjes, pra për të marr masa mbrojtje, se është një qenie e pa mbrojtur, që nuk i shërben vetes.

4. Së fundi hipoteza e “super fëmijës”, që qan për të ngritur me force, që të mos ketë së shpejti një vëlla ose motër tjetër, pra për të vonuar ardhjen e tij dhe që të përqendrohet vëmendja vetëm për te (për veten e tij). Pra, xhelozia e ardhshme për kujdes prindëror, duke tërhequr vëmendjen për ta dashur dhe për mbrojtje të nevojshme. Pra, fëmija kërkon për një kohe të gjatë këtë kujdes dhe edukim dhe nuk mund të shkëputet, vetëm në moshën e rritur nga ky kujdes (në dallim nga kafshët).

-Të qarat e të rriturve kanë objekt më kompleks-si dhimbje fizike, pa rehati; me moshimin, pra, adutët qajnë me rrallë, kur kanë dhimbje dhe bëhen më të ndjeshëm, më emfatike ndaj vuajtjes së të tjerëve-Pra, teoria e atashimit -lidhjes ka gjithnjë ndjenjën e frikës së ndarjes-këtu shtrohet hipoteza e nënshtrimit, bindjes dhe e qetësimi.

Kur qajmë pamja jone është e trishtuar, e prishur, dhe jemi me pak

vigjilent për mbrojtje-Pra, ka dhe një sinjal për ndihme, por lotët mund të shpërthejnë dhe thjeshtë për t'u bërë balle emocioneve, po ashtu tregojnë se është gati për të përballuar sfidat e jetës, dhe donë të adoptojë një sjellje pro sociale në bashkësi.

Ato/ata që nuk lotojnë(qajnë) a janë më pak social?

Për Noum Sobel bashke-autor në Neurologji, lotët ulin agresivitetin, aspekt, të cilin kërkuesit as që e kishin menduar. Lotët e meshkujve a provokojnë te njëjtin efekt? Ekzaminimi i mbi 160 lendeve prezentë në lotët po vijon deri sa të gjendet njeri prej tyre në origjinë.

Në Londër, Michael Trimble pohon:-“Ne injorojmë gjithë njerëzit që nuk qajnë”, nëse lotët janë esencial për lidhjen, atëherë ata që nuk qajnë kur janë më pak social. Ky përfundim i hedhur nga Lord Benecke, psikolog në Cassel--Gjer-

mani, ato që nuk qajnë tregohen më të distancuar dhe me përkushtim, më të pakët social, ato shfaqin ndjenja agresive-tërbim, zemërim dhe neveri më tepër se, ata që qajnë-lotojnë, por sipas Michael Trimble mungesa e lotëve nuk duhet të konsiderohet cen(e mete). Asgjë nuk tregon se të qarit-lotët kanë efekt pozitiv mbi shëndetin. Megjithatë për Jonatan Rottenberg, është një “mit i humbjes”, qarja të bën të eliminosh helmet nga gjaku. Pra, të detoksikohesh fizikisht dhe emocionalisht si gjatë një séance trajnimit, mirëpo nuk ka asnjë prove për këtë teori. Mirëpo, ideja se lexohet gjithnjë pas të qarës, është diçka e tepruar. Por teoritë e tjera, që mbrojnë tezen, se të qarit është një gjetje e mirë, që lejon të eliminohen emocionet e grumbulluara. Por, duhet një afat i mjaftueshëm për të shpërthyer lotët, prandaj shpesh populli thekson,-lëreni të shfryj “dufin”. Pasi është paraqitur një film prekës në ndjenja.

Prof. Wengerhoets et bp. Kane pritur 90 minuta për të matur gjendjen shpirtërore, ku u vërejt se ato që kishin qar, kishin humor me të mirë pas emocioni të fortë se sa në fillim.

Pra, përfundimi i studimeve më të fundit është, se lotët luajnë një rol më qendror se sa besohej dhe ata paraqesin një rendësi të madhe për natyrën njerëzore.

Përgatitur nga

Dr. Med. Ndue Nikaj
PATOLOG - INTERNIST
SHKODËR

THETHI, RRUGA E MUNDIMSHME DREJT TURIZMIT



Ndue Dedaj

Vetëm ata që kanë qenë këtë verë në Theth, e dinë vërshimin masiv të turistëve atje, mbase më shumë të huaj se shqiptarë. Njerëz të ardhur nga larg, me çanta në shpinë, që nxitojnë. Ngjithën kreshtave alpine, që nganjëherë nuk ke se ku të “ngulësh” këmbën thepave shkëmborë. Nuk janë alpinistë, po thjesht eksplorues të natyrës plot befasi. Ka gjasë që Thethi të jetë sot destinacioni turistik kryesor i Alpeve. Janë më shumë se 30 bujtina të mëdha e të vogla, ku turistët gjejnë strehim e ushqim, kampingje dhe lehtësi të tjera.

Jemi nisur drejt Thethit, rrugës së asfaltuar deri në Bogë, aty ku Malësia e Madhe ia lë vendin një tjetër krahine në zë. Qafë-Thorja, është ballkoni natyror nga ku vështrohet malësia e Dukagjinit dhe lugina e Shalës. Makinat ndalojnë në rrafshinën sipër rrugës dhe të ardhurit fotoqafojnë Alpet në sfond, pyjet, shkrepat, pllajajat, hijetin, lugjet. Por aty fillon dhe “ferri” i një rrugë gjithë gropa, prej 17 kilometrash, tërthores mbi greminë, ku nuk dëshiron as të hedhësh sytë. Nuk është aspak i lehtë ndërrimi i fuoristradave, që janë dhe “mbretëreshat” e një udhëtimit të tillë jo pak aventuror, krahas furgonëve të agjencive turistike e të tjera. Çuditëshe me sjelljen prej “xhentëmenësh” të drejtuesve të automjeteve me njëri-tjetrin, që përshëndetën duke ngritur dorën, ndryshe nga zona urbane, ku diçka e tillë mund të duket arkaike. Jo, këtu polici i trafikut është i panevojshëm. “Janë vështirësitë që e kanë krijuar këtë etikë mes bjeshkësh, por dhe fakti që këtu ka shumë të huaj që nuk e njohin rrugën dhe vendësit e ndiejnë për detyrë t’ua lehtësojnë kalimin”, thotë një drejtues mjeti. Një tjetër shton se, kjo ka qenë tradita e malësorëve, me i fol në rrugë të njohurit e të panjohurit, burrat duke ndërruar kutitë e duhanit.

Kush ka parë bjeshkët e Shqipërisë të shkatërruara, me pyje të prera e të djegur, e ka të zorshme ta besojë se Parku Kombëtar i Thethit i ka shpëtuar për mrekulli sharrës së tranzicionit. Drurë ahu, pishe, armeni, bredhi që këndellën në blertësi. Kjo ka bërë që Thethi të vijojë ta ruajë mistikën e tij, si në lirikën e Martin Camajit. Ta shtojnë këtë ndjesi retë dhe mjegullat që u mvishën majave të thepisura alpine. Njerëzit vijnë këndeje tamam për këtë, të virgjërën e natyrës, të patjetërsueshmen e saj. Ata, që kur nisën

nga Tirana a Nju Jorku, nga Polonia e Çekia e sa e sa adresa të tjera, kanë planifikuar të shtegtojnë në këmbë për tek Ujëvara 25 metra e lartë, kanionet e Grunasit, vaskat, Syri i Kaltër, shpellat, kurse më të palodhurit ecin në këmbë 4-5 orë deri në Valbonë.

Ndalesën e parë në Theth e bëjmë në hotelin, që dikur ka qenë kampi i pushimit të punëtorëve. Kemi qenë dhe në fillimin e viteve ‘80 këtu, kur ishim studentë, por tashmë pamja është krejt tjetër. Një qytezë turistike gjithë vila – bujtina dy

kushtuar Edit Durhamit, ku vizitorët bëjnë fotografi me “krajlicën e shqiptarëve”. Në Theth është dhe një monument kushtuar veprimtarëve të Kryqit të Kuq Amerikan, ardhur këtu në fillimet e shekullit XX. Ashtu siç shaljanët e kanë, shtëpi për shtëpi, librin “Majat e Shalës” të amerikanes Rose Eilder Lane, që tashmë ia kanë kthyer vizitën, duke shkuar ata në vendin e saj si turistë apo emigrantë. Në Theth, dy vjet më parë, erdhi për t’u prehur përjetësisht albanologu Robert Elsie dhe ne meditojmë pranë memorialit të tij

e sotme të Lazër Stanit. Ti kundron peizazhin e pazakontë bjeshkatar dhe beson se “Lekët” e tij kane dalë nga ashti i këtyre kreshtave heroikë. Surpriza është një Kanun i Gjeçovit i vitit 1933, në bujtinën “Polia”. Nikollë Polia, 65-vjeçar, bashkë me të shoqen, Sofinë, jetojnë në Nju-Jork te vajzat, kurse bujtinën e tyre turistike e menaxhon i biri, Pavlini. Shumë nga të zotët e bujtinave iu kanë vënë atyre emrat e maleve përreth, si Bjeshkët e Namuna, Radohima, Jezerca, Harusha, Polia, Zorgjia, Okoli, Shpella, siç kanë dhe për



e trekatëshe, përgjatë luginës së Thethit, prej ku buron lumi i Shalës në Okol e deri poshtë në Ndërlyaj. Veçse me problemet e veta të urbanizimit, kanalizimeve, energjisë elektrike e gjer tapive. Thethi përmendet në dokumente në vitin 1485 dhe përbëhet nga dhjetë lagje: Okoli, Nikgjona, Gjeçaj, Gjellaj, Stafaj, Ndreaj, Ulaj, Kolaj, Grunasi e Ndërlyaj, të cilat nuk i lexuam ndokund, por na i thanë banorët, teksa na shpjegonin me pasion vendin e tyre, të braktisur jo pak, por që ia fsheh këtë plagë disi turizmi. Përndryshe, mund të thuhet se Thethi “fle” në dimër e zgjohet në pranverë. Ngjarja më e shënuar e tij është Zâ-Fest dhe afishja e koncertit të Vlashent Satës dhe Elina Dunit, në fillim të gushtit, është ende aty pranë.

“NA NDIHMO, ORA E SHALËS!”

Thethi (mendohet se vjen nga thep, thellë e të tjera), 70 km nga Shkodra, që nis në 750 metra mbi nivelin e detit, ka pritur e përcjellë albanologë të shquar, që tash i ka të skalitur në gur. Në Qafë-Thore është një pllakë me profilin e Franc Nopçës, më tej një memorial në gur të bardhë

të gurtë, gdhendur me simbolika të lashta shqiptare. Çfarë magjie iu ka bërë ky vend dijetarëve të Evropës, që na e lanë “amanet” neve, njëllor si stërgjyshërit tanë.

Por Thethi ka dhe historinë e lartësuar të bijve të tij meshtarë e dijetarë. At Daniel Gjeçaj (alias Pal Dukagjini) dhe At Amroz Martini janë dy prelatë thethianë, model i përkushtimit dhe sakrificës njerëzore. At Danieli, që ka shkruar dhe një monografi për Gjergj Fishtë, fliste në Radio-Vatikan kundër stalinizmit shqiptar. Kurse At Ambrozi u kthye mbas 50 vitesh emigrimi politik i mplakur. Ai e niste meshën me fjalët: “Ndihamo Zot e Ora e Shalës”. Na thonë se Orën e Shalës e lutnin dhe shoferët, sa dilnin në Qafë-Thore, teksa kalonin sipër greminave të frikshme me ngricë e akull. Në Iballe kemi dëgjuar për Orën e Malit të Shllumit, që i luteshin banorët e aneve të Drinit. Si duket, bota alpine asnjëherë, dhe në kohë moderne, nuk do të pushojë së qeni nën pushtetin e orëve, zanave dhe kreshnikëve. Pa humusin pjellor dukagjinan nuk mund të kuptohet letërsia e Ernest Koliqit, këngët e gojëdhënat mbledhura nga Barnardin Palaj e gjer tregimet

vete mbiemra lulesh, bari, drurësh, gurrash e çetinash. Nuk ka këtu emra të huaj si në baret e Tiranës e gjithandej, por kjo nuk do të thotë se dhe kuzhina ka mbetur tradicionale, siç do të lypej. Dakord, që këtu ka dhe kuzhinierë e gatime italiane, por pa zëvendësuar gatimet e amvisave të zonës, që dinin aq mirë të gatuanin bukën e misrit, të bënëin djathin e dhisë, mazën e tamblit e të tjera.

TURIZMI ALPIN, SFIDË E BANORËVE DHE QEVERISË

Edhe pse po bëhen njëzet vite që kur janë hapur bujtinat e para, në Theth, Valbonë e Pukë, prapë jemi në fillimet. Turistët mund të vijnë një herë për të shuar kureshtjen, kurse të përhershëm i ke vetëm kur ke arritur standardet si në Tiroli e të tjera. Alpet sot janë thirrja e ditës e turizmit malor, ndonëse lartësitë bllokohen nga dëborat për 6 muaj, nga nëntori në maj. Për t’i dhënë hov këtij turizmi, qeverisë i është propozuar të krijojë agjencinë e zhvillimit të Alpeve, ashtu si ajo e bregdetit.

Sa i përket Thethit, disa prej kreshtave,

rreth e qark “gropës” së tij, janë Shtegu i Dhënëve, Mali i Radohimës (deri në 2500 m), i Shenikut, i Paplukut, Maja e Harapit si piramidë, përkulur si Kulla e Pizës, Maja e Hekurave, Qafa e Pejës, Maja e Alisë, Qafa e Valbonës, Maja e Madhe, Maja e Drenit, Maja e Zorgjit e të tjera. Çdo mal, qafë e grykë, këtu ka legendën e saj. Për Shpellën e Rrathëve thuhet se macja ka hyrë aty e ka dalë në Curraj Epër disa kilometra përtej. Kurse shpjegimi për Malin e Hekurave është si për Malin e Velës, me ankimin e anijeve në majmal kushedi se në ç’epoka gjeologjike. E tillë është fantazia e malësorëve, e ka ngjitur detin deri në qiellin e Alpeve. Kurse lumenjtë që burojnë prej Bjeshkëve të Namuna janë: Valbona, Shala, Cemi dhe Skafkaçi i Vuthajve. Nga krojet, të mbetet në mendje Kroji i Nuseve në Bogë. Aty ku derdhet lumi i Shalës, në liqenin e Komanit, është krijuar një nga pikat turistike më të lakmuara, edhe pse duhet të udhëtosh për disa orë nëpër liqen me varkë për atje.

Atij që vjen, i duhet informacion dhe mësuesi pensionist Zef Bari, veprimtar i shoqatës atdhetare “Dukagjini”, që ka qenë për 15 vite ciceron i turistëve, t’i rreshton një për një ngjarjet më të rëndësishme, pa qenë nevoja të hapë ndonjë letër. Shkolla është çelur në vitin 1917 nga Gjeçovi. Në vitin 1921, Kryqi i Kuq Amerikan ka ndërtuar shkollën e ka hapur kurse. Më 1936 është hapur rruga e makinës dhe është krijuar një agjenci turistike. Më 1956, Thethi bëhet qendra e parë e alpinizmit në shkallë vendi. Nga fundi i viteve ’60, ndërtohet shtëpia e pushimit të punëtorëve me 200 shtretër, si Qafë-Shtama në Krujë e të tjera, ku çdo verë Thethi dyfishohej.

Në vitin 1967 u nxit nga lart nisma: “Ta bëjmë fshatin si bora e bjeshkëve dhe t’i rrisim fëmijët si çetinat (pishat)”. Kjo kishte të mirën se u hoqën bagëtitë nga ahërat e kullave, por pati të keqen se u prish arkitektura e kullave të vjetra, u hapën dritaret ae plota e të tjera.

Më 1976, Thethi shpallet park kombëtar dhe ka 11 monumente natyre e 8 kulture. Në ‘90-n, Thethi kishte rreth në 1200 banorë dhe shkollën e mesme. Tani “banorët” e Thethit janë turistët. Na thonë se nuk ka pasur asnjë incident me ta, ndihen të qetë bjeshkëve të vetmuara. Kjo, dhe për faktin se turistët jetojnë bashkë me familjarët. Sot hyjnë 300 turistë çdo ditë, bujtin 500 në natë dhe ka 100 të punësuar. Numri i tyre vitin e kaluar ka qenë rreth 40 000 e këtë vit edhe më shumë.

VIRGJËRESHA TË PËRBETUARA DHE HISTORI DASHURIE

Virgjëreshat e përbetuara kanë qenë disa në Dukagjin. Ato visheshin dhe silleshin si burra, edhe pse brenda tyre ishte femra. Na tregojnë për virgjëreshën e fundit të këtyre anëve, Pashke Sokolen. I vdiq i ati dhe atëherë ajo ndenji me ungjin e saj plak, ngaqë nuk kishte kush të kujdesohej për të. Për Pashken është bërë dhe një dokumentar sa ishte gjallë.

Ndoc Pisha na pret në shtëpinë e tij, bujtinë për një kafe. Aty është dhe nëna e tij 90-vjeçare, Sosja. Ajo është bijë nga Ndrepepajt e Toplanës dhe e ka marrë burrin me dashuri. Nuk ka pritur eman-



cipimin e ‘67-s, por e ka “emancipuar” ajo vetë malësinë e saj, njëzet e sa vjet para Partisë dhe jo me “zjarr e hekur” si kjo. Sosja e re dhe e bukur vinte në Theth për të blerë dhe i ra në kokë për Dedë Pishën. U dynd Toplana për ta ndaluar këtë martesë, pasi ishte shkelur tradita, ngaqë vajza ishte e fejuar qysh në djep. Por Sosja nuk ndryshoi mendje. E fitoi betejën me burrat sojli të maleve. Përpiqesh t’i gjesh ngjasim me personazhe të letërsisë botërore, por nuk duket se ka. “E pashë burrin në andërr...”, thotë ajo me të qeshur. Një tjetër personazh i këtushëm është Motër Antonia, që shërben në Lituani. Iu bashkua Nënë Terezës kur erdhi në Shkodër në ‘90-n dhe nuk i u nda më. Ka qëndruar një vit në Indi, si të gjitha motrat e Shenjtores.

Këtu, kullat janë zgjatim i gurit. Edhe dy kullat e ngujimit, e Thethit dhe e Lotajve. Te Muzeu Etnografik i Dukagjinit, një kullë në gur, krijuar më 1972, i zoti i saj, Dedë Boshi, na thotë se e kanë lënë pas dore këtë objekt, që tani është duke i rënë çatia. Ai e përcjell shqetësimin e tij për institucionet e trashëgimisë kulturore në Shkodër, por dhe Ministrinë e Kulturës, nisur nga rëndësia që ka sot Thethi turistik. Nuk është e përligjur që turistëve t’iu prijë vetëm te shpellat, por dhe te një muze për të qenë.

KUFIRI I PAKUFISHËM, ME TË ARRATISUR E KUFITARË

Thethi nuk mund të kuptohet pa historitë e tij të kufirit, që janë të pakufishme. Në vitin 1979 ka ikur, më 16 tetor (qëllimisht në ditëlindjen e Enverit), një

familje e madhe, e fisme, por e persekutuar, me 16 veta dhe sot janë në Amerikë. Në një rast tjetër kanë ikur fillimisht burrat. Disa kohë më vonë, gratë dhe fëmijët dalin natën nëpër mal, me pisha në duar, duke kërkuar “lopët” e humbura. Kufitarët ua lejojnë kërkimin deri në njëfarë vendi, por gratë e dinin kufirin më mirë se ushtarët dhe, me të kaluar njërin nga leqet, kishin fikur pishat dhe ishin hedhur matanë, duke u bashkuar pas disa kohësh me burrat e shtëpisë e përfunduar dhe ata në Amerikë. Të bën përshtypje se Amerika e lirisë shihej aq mirë nga këto gryka të thella e të “namuna”. Por ka pasur dhe histori tragjike, jo të gjithë e kanë mbërritur ëndërrën, kështu në një përplasje janë vvarë tre veta, që donin të arratiseshin dhe po aq ushtarë e policë. Askush nuk donte të bënte shaka me jetën, arratisja për në Perëndim nuk ishte një aventurë ekzotike, për luftë për ekzistencë. Zef Marashi, në Kir, pushkatohet në oborrin e kishës, se, si kryetar i fshatit, tha para Forcave të Ndjekjes se fshati nuk ka armë për të dorëzuar. Pas kësaj, Shanja, gruaja e tij, që vinte nga familje komuniste, kur kishte votime, thoshte hapur: “Për besë, këta më kanë vvarë burrin dhe nuk jam tue e hedh votën për Frontin”, dhe e hidhte fletën në kutinë boshe. Ky është Dukagjini i grave të pabujshme dhe i burrave në këngë, si Mark Lula, Mehmet Shpendi, Ndoc Martin Camaj, Kolonel Ndok Gjeloşi e të tjera.

TURIZËM APO EDHE AGROTURIZËM?...

Rruga nga Qafë-Thorja deri në Theth është jashtë çdo standardi, ndonëse e

premtuar disa herë. Por, siç na thanë, pritet të fillojë nga dita në ditë. Makineritë e rënda janë ngjitur atje. Më në fund, qoftë e thënë. Dhe nuk është e lehtë, kur sheh mbrojtëset metalike anësore të dëmtuara nga borëpastrueset, në kthesat e Bogës, pasi në dimër bora shkon mbi dy metra dhe traseja nuk shihet. Në të vërtetë, zgjidhja përfundimtare do të ishte jo kjo rrugë nga bjeshkët, që zihet dimrave, por ajo “fushore” nga Prekali e Shoshi, hapur më 1970 për tre muaj me aksion. Rruga sjell dhe turizmin dimëror. Pse jo, edhe ndonjë spital kurativ, pasi Thethi ka klimën më të mirë në viset turistike. Thethi, njëherësh, është dhe një nga tri stacionet shqiptare të shtegtimeve në Alpet e Ballkanit, bashkë me Rugovën e Plavën.

Por nuk është vetëm rruga, ka dhe një problem, si me thënë, të brendshëm. Thethi e ka turizmin, por nuk mund të themi sa ka dhe agroturizmin? Dikur këtu prodhohej misri, fasulet, patatet, perimet, siç bëhen dhe kumbullat, thanat, mollët, dardhat, arrat, kurse rrushi jo dhe aq. Teksa në bjeshkë mbahej gjëja e gjallë dhe merrej bulmeti. Ndërsa sot, me prodhime vendi, bujtinat furnizohen kryesisht nga Shala dhe pak nga vetja. Sallatë me domate të blera në Shkodër nuk do të donte kush në Theth. As coca-cola në vend të dhalltit e lëngut të boronicës. Duket sikur të gjithë janë dhënë pas tregtisë dhe jo prodhimeve bio. Është koha tani të mendohet seriozisht për këtë. Në të kundërt, e nesërmja e turizmit këtu nuk dihet si do të vejë!...

Gazeta “PANORAM”,
28 gusht 2019

Dante continua...

(Dante vazhdon)


*Non si può tradurre Dante, in qualsiasi lingua,
prima di aver preso una decisione
interpretativa circa il testo italiano.¹*

Shqipja asht një ndër gjuhët botënore, ndoshta ndër të paktat, që vijon ende sot e kësaj dite me iu përgjigjë përkthimit të poezisë klasike, e cila rruen aspektin formal. Pra, ku respektohet rrafshi metrik dhe konvencionaliteti i rimës. Rast konkret - tue marrë parasysh edhe disa nga edicionet e vona europiane - asht edhe përkthimi i kanti-kut të *Ferrit* nga z. Meritan Spahija.

Në studimet përkthimore të *Komedisë*, apo tekstet e tjera të Dantes, mungojnë interpretimet e organizimit të përgjithshëm të komponentëve, që bajnë të mundun mbërritjen pothuaj të njëjtë të tekstit nga origjinali: gjegjësisht nga italishtja në shqipe. Qofshin këto përkthime sekuenciale, qysh me variantin e parë të Sokol Bacit në "La Nazione Albanese", e deri tek varianti i mbramë i *Ferrit* nga Çezar Kurti (bot. I, II, New York, Kurti publishing, 1996, 2004/bot. III, New York; Ottawa: Legas, 2013). Shkolla shqipe e teorisë së përkthimit, e cila vijon me pasë teoricienë të ligsh të kuptimit ma të plotë e ma të kësaj fjale, nuk ka krijuar një model konkret të strategjisë ose korpuseve strategjike mbi analizën e produktit përkthimor. Kjo ka ndodhë për shkak të intervenimeve të estetikës komuniste, atëbotë kur Pipa, Kokona e me radhë i kanonizuen disa principe teorike të përkthimit. Sigurisht asht një kohë e largët (relativisht) prej viteve kur shkruenin ata, sepse përkthimologjia në botë asht një fushë e përditësuese dhe me përfaqësues eminentë. Ku e ku me disa libërtha që ekzistojnë sot për sot në tregun dhe bibliotekat e Shqipnisë, e ma gjanë në hapësinën shqipfolëse.

Ndërkaq publiku shqiptar u lidh me kultin e idolit (idhujtarisë në terma të tjerë), i cili e ka shumë të vështirë me e pranue versionin e ri, variantin e një vepre që asht ba "simbol" i përkthimit. Me guxue kush sot me ripërkthye *Hamletin*, do të shpallej heretik pa e dorëzue materialin në shtypshkronjë. Në të tilla kushte ndodhet dhe Spahija me *Ferrin* e tij. Miq e lexues të dashtun, nuk po flasim për herezi, por për alternativë, siç ngjet në krejt botën. Po flas këtu prej statusit tim dhe përvojës modeste në fushën e përkthimit. Kur ne, së bashku me mikun e kolegun z. Vinçens Marku, e nisëm punën me pru në shqipe Pseudo-Longinin, kishim konstatue se në anglisht ekzistojnë mbi njëzetë variante e në italisht mbi sa e sa variante. Por një gja e tillë na ka ba të mundun me krahasue rreth shtatë variante, që me u afrue sa ma shumë me kuptimin e duhun të veprës. Dhe unë personalisht do të isha shumë i lumtun sikur të ketë një variant të dytë e të tretë të së *Madhërishmes*. Kështu pra, sa i takon nocionit të idolit që fola pak ma nalt, mundem me thanë se korifeu i përkthimit Noli mundet me u sprapsë sadopak. Një gja e tillë na e ka dëshmue Guljelm Deda me *Orlandin e çmendun*, i cili ka sjellë një produkt tej mase cilësor dhe ka hapë mundsinë e gjykimit të historisë dhe atributit të primatit të përkthimit në gjuhën shqipe. Gjithmonë nëse ka me pasë një vullnet të tillë, sepse njerëzit që "konstituojnë" kulturën tonë nuk e pranojnë, ngaqë: "zemra e tyne asht [sic!] e lidhun me idhujt e tyne" (Ezekieli, 20: 16). Por kjo s'don me thanë se për hir të statusit tradicional të një iks përkthyesi me u frenue që me e ripërkthye një vepër, të ardhun tashma në gjuhën shqipe. Për këtë duhet të jemi të qartë, se *Hamleti* i Nolit asht po kaq i largët me shqipen e sotme sa edhe *Komedia Hyjnore* e Gjeçit a e Ndojës.

Për rastin e edicionit të parë në shqip të *Komedisë Hyjnore*, apo variante të tjera përkthimore, nuk asht rasti



Komedia Hyjnore FERRI DANTE ALIGIERI

PËRKTHEU DHE KOMENTOI
MERITAN SPAHIJA

me u ndalë në probleme të thella drejtpërkthimore, për të cilat kanë folë Martin Camaj, Filip Ndocaj apo studiues të tjerë, tue renditë dhe veten.² Qëllimi i kësaj trajtëse të shkurtë, njikohësisht, nuk asht me ba një paraqitje krahasuese mes teksteve, tercinave, apo aspekteve tjera të veprës në fjalë, dhanë shqip nga përkthyesit pararendës. Por unë do të ndalem në disa konstatime të përgjithshme të përkthimit. (Ndërkaq, varianti përkthimor i *Ferrit*, komentet dhe reflektimi i neologjizmave të këtij produkti nga ana e z. Spahija flasin ma shumë se çdo fjalë e imja, në këtë status e ndihmesë që kam). Këto konstatime, kam arritë me i vu re gjatë punës mbi gjashtëvjeçare si redaktor i këtij edicioni që asht sot para jush. Me kangë të veçanta kam punue me ma shumë se 5-6 variante, - përfshi pa diskutim origjinalin [alfa e punës], variantet shqip të kangëve, si dhe anglisht e gjermanisht, - në mënyrë që me ba një punë sa ma të dobishme për publikun.

Shpesh më ka qëllue rasti me lexue apo ndigjue se një tekst asht përkthye në një *gegërishte* të ëmbël, sikur ajo të ishte *dessert* servirë në ndonjifarë *fancy restaurant*. Gjith-

sesi nëse flasim me të njëjtin konotacion diskursiv, mundem me thanë se gegënishtja e ambël e Gjeçit asht ba edhe ma e ambël. Kjo jo për faj të përkthyesit, assesi, por për shkak të natyrshme evolutive të gjuhës. Në botë vetëm standardi i gjuhës shqipe, nuk ka evolue tash 45 vjet, tue u ba kësodore një qenie e fosilizueme - ndërkohë që gjuha asht një instrument i gjallë, e prirë për me ndryshue në dinamikën e vet. A mundet njeriu me jetue në po ato mobilje që po i afrohen gjysmës së shekullit? Tue lanë mënjane këtë pyetje, në pamje të parë pa lidhje me argumentin, po kthehem aty ku zumë fill. Për me dashtë me provue cilësinë e një përkthimi, detyra e parë asht krahasimi me tekstin nisës. Era moderne na ka mësue se ekzistojnë disa elementë të tjerë teknikë e profesionalë, që e kanë lanë mbas dore punën e "veshit". Nuk ka ma se tingëllon bukur, a më rrin mirë në vesh. Po ba me qenë shurdh, ose me pasë një vesh të trashë e aq ma tepër dy!? Le të jetë fryt, pra, i disa gjykimeve tona rezultantja e tekstit A (burimor) dhe atij B (mbërritës).

Siç dihet, *Komedia Hyjnore* ka një konfigurim formal të shprehun me anë të tercinës (organizimit strofik pagëzue nga vetë Dante), që realizohet simbas rimës zinxhirë: *aba bcb cdc ded...* Dhe e gjithë poema asht e shkrueme në varg

¹ Nuk mund të përkthehet Dante, në asnjëfarë gjuhe, pa marrë përsipër komentimin e tekstit në italisht - Umberto Eco, *Dire quasi la stessa cosa: esperienze di traduzione*, Bompiani, Milano 2003.

² Shih: "Dante Alighieri përmes përkthimit të Pashko Gjeçit, te kanga e parë e *Ferrit*: përqsaje. Gjurmime në tekstin dantesk." Botue në Buletinin Shkencor të USH, nr. 61, Shkodër, 2011, ff. 111-122.

